

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5886
E martë, 24 shtator 2019
çmimi 0.40 €

BE-ja i jep mbështetje vazhdimit të dialogut

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", FAZLI HOXHA | FAQE 4-5

PROJEKTI 'BASHKË PËR SHTETIN' PO MBËSHTETET NË GJITHË KOSOVËN



Anëtari i Kryesisë së Nismës Socialdemokrate dhe kandidati për deputet nga radhët e koalicionit Nisma-AKR-PD, Fazli Hoxha, ka bërë me dije se ky koalicion i ka hyrë garës zgjedhore me synimin për të dalë fitues. Ai ka treguar se projekti 'Bashkë për shtetin' po gjen mbështetje kudo në Kosovë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se fuqia e

Nismës në Gjakovë dhe në gjithë Kosovën do të shihet më 6 tetor. Sipas Hoxhës, koalicioni Nisma-AKR-PD do të jetë përcaktues për formimin e qeverisë së ardhshme. Ai ka thënë se pas 6 tetorit Kosovës i duhet një qeveri reformatore pasi, sipas tij, përfundimi i procesit të dialogut do të jetë një prej vendimeve të mëdha të qeverisë së re.

Në këtë intervistë Hoxha ka folur edhe për përdorimin e veturave zyrtare në fushatë, duke e vlerësuar shembull të keq

OPINION

ADEM DEMAÇI - BACA, SHASHIVAR MAKOLLI - QALI DHE BAJRUSH BEHRAMI - BALI! F. 10-11

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



AKTUALE



GJENERATA E PARË E KADETËVE TË FSK-SË FESTON 10-VJETORIN E DIPLOMIT F. 5

INSTITUTI I SHËNDETËSISË: NDOTJA E AJRIT PO KËRCËNON SHËNDETIN E POPULLATËS F. 7

EKONOMI

LLUKA: FRANCA, PARTNERE E RËNDËSISHME PËR ZHVILLIMIN E KOSOVËS F. 8

AGJENCIA KADASTRALE, VIZITË ZYRTARE NË SEUL F. 8

KULTURË

NGA TAKIMET ME ADEM GASHIN F. 6

Izet ABDYLI

SPORT

14 GOLA NË TRI NDESHJE TË SUPERLIGËS F. 15

Slogani i KQZ-së për zgjedhjet e 6 tetorit: 'Trego fuqinë tënde, voto'

'Trego fuqinë tënde, voto' është slogani i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për zgjedhjet parlamentare të 6 tetorit i cili është miratuar në mbledhjen e së hënës. Ndërsa kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, ka reaguar pas publikimit të videos nga diaspora lidhur me keqpërdorimin e votave, duke thënë se votimi jashtë Kosovës mund të cenohet lehtë. Po të hënën drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka mbajtur takim me menaxhmentin policor të nivelit qendror dhe



atij lokal lidhur me angazhimin e policisë për zbatimin e planit policor për "Zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2019" | FAQE 7



Veseli: Brenda dy vjetësh çdo familje do t'i marrë fletët poseduese për pronat e veta | FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Correl: Garda Kombëtare e Ajovës do të vazhdojë të mbështesë FSK-në

Gjeneralmajori Ben Corell ka thënë se jam i nderuar që përfaqësoj Gardën Kombëtare të Ajovës këtu në Kosovë dhe ne do të vazhdojmë të jemi të angazhuar dhe të mbështesim Forcën e Sigurisë së Kosovës



PRISHTINË, 23 SHTATOR - Gjeneralmajori Ben Corell, gjatë vizitës së parë në Kosovë prejse u emërua në këtë pozitë, ka thënë se Garda Kombëtare e Ajovës do të vazhdojë të mbështesë Forcën e Sigurisë së Kosovës.

"Jam i nderuar që përfaqësoj Gardën Kombëtare të Ajovës këtu në Kosovë. Ne do të vazhdojmë të jemi të angazhuar dhe të mbështesim Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ambasadën e SHBA-së", tha Corell, ka njoftuar Ambasada amerikane në Prishtinë.

Corell, i cili pason gjeneralin Tim Orr në pozitën e adjutantit të përgjithshëm të Gardës Kombëtare të Ajovës, do të qëndrojë në Kosovë gjatë javës.

Orr për herë të fundit ka qenë në Kosovë më 7 maj, 2019, në vizitë lamtumirëse.

Orr është dashur të vizitojë

Kosovën edhe në shkurt, në prag të përvjetorit të pavarësisë së Kosovës, por Qeveria amerikane ka vendosur që ta anulojë atë vizitë për shkak të taksës që u ka vënë Kosova prodhimeve të importuara nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina.

Në deklaratën e Ambasadës amerikane në Prishtinë, të lëshuar të hënën, thuhet se "që nga viti 2011, Garda Kombëtare e Ajovës ka qenë partner shtetëror i Kosovës, duke ofruar mbështetje për Forcën e Sigurisë së Kosovës".

"Ajo që e bëri këtë partneritet shtetëror unik, është se Ajova ka një qasje gjithëpërfshirëse shoqërore, duke përfshirë të gjitha nivelet e qeverisë, arsimin, atletikës, biznesit privat, energjisë dhe bujqësisë", thuhet në deklaratën e Ambasadës së SHBA-së në Prishtinë.

Meta kërkon transparencë për evidentimin e pasojave të tërmetit

TIRANË, 23 SHTATOR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, pas tërmeteve që kanë tronditur vendin, ka thënë se duhet ruajtur qetësia nga të gjithë, derisa ka vënë theksin në rëndësinë e frymës së bashkëpunimit dhe solidaritetit njerëzor, pa përjashtim, nga aktorët institucionalë, politikë, shoqërorë dhe mediatikë, për normalizimin e plotë të situatës.

"Transparenca dhe përgjegjshmëria maksimale për evidentimin e pasojave është tepër e rëndësishme në këto momente", ka thënë Meta.

Ai ka thënë se vlerësimi teknik i banesave, pallateve dhe godinave të dëmtuara është tepër i domosdoshëm për të ardhmen.

Duke vlerësuar edhe solidaritetin e



vendeve partnere dhe Bashkimin Evropian, presidenti Meta i ka kërkuar Qeverisë të ftojë zyrtarisht edhe Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike, që ka kapacitetet e duhura për të përcaktuar sigurinë dhe rezistencën e banesave, pallateve dhe godinave të dëmtuara nga kjo fatkeqësi e natyrës.

"Keqpërdorimi nga kushdo i kësaj situatë, nuk është rruga e duhur për të përballuar një shqetësim të përgjithshëm, në mënyrë të bashkuar dhe të përgjegjshme, vetëm në interes të qytetarëve të traumatizuar nga tronditjet dhe pasojat në banesat e pronat e tyre. Të gjithë duhet të shtojnë kontributet pozitive dhe solidarë në bazë të përgjegjësisë institucionale, politike, shoqërore dhe qytetare", ka thënë Meta.

Aleatët i kërkojnë Bashës të krijojë senatin e opozitës

TIRANË, 23 SHTATOR - Aleatët e Lulzim Bashës, kërkojnë prej tij afrimin e të gjithë kontributeve ndër vite përfshi edhe të atyre të cilët u larguan prej lider-shipit demokrat përmes listave për deputet.

Propozimi i partnerëve kryesorë të lider-shipit demokrat parashikon krijimin e dy organeve: senatit të intelektualëve dhe këshillit të ish-zyrtarëve.

"Krijimi i senatit të opozitës. Figura politike dhe qeverisëse të opozitës, si dhe afrimi i intelektualëve në emër të bashkëqeverisjes. Këshilli i ish-deputetëve, ish-ministrave, në të gjitha legjislaturat dhe kryetarëve të bashkive. Grup që do analizojnë punën e qeverisë dhe do bashkëpunojnë me strukturat, për të ndërtuar trupën konkurruese, për pushtetin lokal dhe qendror", thuhet në dokument.

Një vëmendje të posaçme i kushtohet marrëdhënies me ndërkombëtarët bashkë me të cilët kërkohet t'i jepet fund krizës poli-



tike. "Dialogu për zgjidhjen e krizës së rëndë politike me prezencë të ndërkombëtarëve, me prioritet zgjedhjet e lira dhe të ndershme, si rruga për daljen nga kriza", thuhet në atë dokument.

Reforma zgjedhore është prioritet për të vegjlit andej për të dalë me një qëndrim të përbashkët lihet edhe një afat, 28 shtatori i këtij viti.

"Në këtë kuadër, të gjitha partitë e koalicionit, të paraqesin opsionet për reformën zgjedhore, deri në përcaktimin e një qëndrimi të përbashkët. Propozimet të paraqiten me shkrim brenda 10 ditëve.

Institucionizimi i vendimmarrjes së koalicionit opozitar është në thelb të platformës prej 7 pikash. Aleatët propozojnë mbledhje të detyrueshme një herë në dy javë me kërkesë të çdo njërit prej kryetarëve të opozitës me subjekt të caktuar çështjesh dhe të shoqëruara me vendimmarrje të shkruar", thuhet në dokument.



Talat Xhaferi për vizitë në Kazakistan

SHKUP, 23 SHTATOR - Nga kabineti i kryetarit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut kanë njoftuar se Talat Xhaferi së bashku me Enes

Ibrahimi do të vizitojnë Kazakistanin.

Ai të hënën dhe sot (e martë) do të marrë pjesë në takimin e kryetarëve të kuvendeve të

vendeve të Euroazisë me temë: Euroazia e Madhe: Besim, partneritet", e cila do të mbahet në Nur-Sultan në Kazakistan.

Në takim do të marrin pjesë delegacione nga gjashtëdhjetë vende dhe 39 kryetar të kuvendeve kombëtare nga Evropa dhe Azia.

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka vazhduar vizitën në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA)

BE-ja i jep mbështetje vazhdimit të dialogut



Bashkimi Evropian (BE) edhe një herë i ka dhënë mbështetje vazhdimit të dialogut Kosovë - Serbi. Shefja e politikës së jashtme e Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, në Nju Jork ka shtruar një darkë për liderët e vendeve të rajonit, në të cilën është shprehur mbështetja për arritjen e shpejtë të një marrëveshjeje ligjërish të detyrueshme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

hënëve", është thënë në një komunikatë për medie të Shërbimit për Punë të Jashtme i BE-së.

Në këtë takim, përveç presidentit Hashim Thaçi, ka marrë pjesë ministri i Jashtëm i Serbisë, Ivica Dačić, kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, si dhe zyrtarë nga Shqipëria dhe Bosnje e Hercegovina.

Thaçi merr pjesë në inaugurimin e programit "Women in Energy"

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka marrë pjesë në inaugurimin e programit "Women in Energy" dhe në shpalljen e vitit akademik 2019/2020 në "Des Moines Area Community College" (DMACC) si "Viti i Kosovës".

Në fjalimin e tij në këtë ceremoni që u mbajt në kompleksin e DMACC në Des Moines, Iowa, ai është shprehur i lumtur me programin "Women in Energy" dhe me përfshirjen e 28 vajzave nga Kosova si studente që do të specializohen në sektorin e energjisë. Sipas tij, ky program

Pacolli në Nju Jork takon homologët e tri shteteve

Ministri i Jashtëm i Kosovës në detyrë, Behgjet Pacolli, është duke marrë pjesë në punimet e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Gjatë kësaj vizite Pacolli është takuar në Nju Jork me ministrin e Punëve të Jashtme të Guajanas, Karen Cummings, me ministrin e Shtetit për Punë të Jashtme të Katarit, Soltan bin Saad Al-Muraikhi, prej të cilëve ka kërkuar mbështetje për Kosovën. "Katarit është një partner i besueshëm i Kosovës dhe mbështet zhvillimin tonë ekonomik dhe politik", ka deklaruar Pacolli.

është i veçantë në shumë rrafshë. "E para, ofron përgatitje profesionale për një sektor të rëndësishëm në Kosovë, pra për sektorin e energjisë. E dyta, përkrah përfshirjen më të madhe të gruas në sektorin e energjisë duke kontribuar kështu në fuqizimin e përgjithshëm të gruas në shoqërinë kosovare. E treta, shënon zgjerimin e bashkëpunimit në mes të Iowas dhe Kosovës në një sektor tjetër të rëndësishëm, atë të energjisë", ka thënë Thaçi.

Para 28 studentëve nga Kosova, presidenti Thaçi ka thënë se dëshiron që t'i përfundojnë me sukses studimet dhe ta marrin

rolin që u takon në shoqëri. Një ditë më herët ai ka vizituar Gardën Kombëtare të shtetit Iowas, ku është pritur nga gjeneralmajori Benjamin Corell dhe ka takuar pjesëtarët e FSK-së që janë duke ndjekur trajnimet atje. Për shkak të punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, presidenti Thaçi është duke e zhvilluar një vizitë zyrtare në ShBA, ku pritet të takojë krerë shtetesh të vendeve nga bota dhe liderë të organizatave ndërkombëtare. Takimi kryesor i presidentit Thaçi do të jetë pritja e presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump.

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka marrë pjesë në darkën e shtruar nga përfaqësuesja e Bashkimit Evropian (BE), Federica Mogherini, së bashku me liderët të vendeve të tjera të rajonit. Shefi i shtetit ka bërë me dije se në këtë takim është rikonfirmuar edhe një herë përkushtimi i shteteve të rajonit për paqe dhe stabilitet, për zhvillim dhe integrim në Bashkimin Evropian. "Mbrëmë mora pjesë në darkën e shtruar nga përfaqësuesja BE-së, Federica Mogherini, së bashku me liderë të vendeve të tjera të rajonit. Në këtë takim u rikonfirmua edhe një herë përkushtimi i shteteve të rajonit për paqe dhe

stabilitet, për zhvillim dhe integrim në Bashkimin Evropian", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Takimin me udhëheqësit e Ballkanit Perëndimor, i cili është zhvilluar në margjina të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, e ka konfirmuar edhe shefja e politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini. Ajo ka shprehur mbështetjen për vazhdimin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë. "Në takim u shpreh mbështetja për vazhdimin e dialogut midis Beogradit dhe Prishtinës dhe për arritjen e shpejtë të një marrëveshjeje ligjërish të detyrueshme për normalizimin e plotë të marrëdhënieve", është thënë në një komunikatë për medie të Shërbimit për Punë të Jashtme i BE-së.



Ferid Agani rizgjedhet kryetar i PD-së edhe për një mandat

Prishtinë, 23 shtator (ER) - Partia e Drejtësisë (PD) dje ka mbajtur Kuvendin e Tetë të Rregullt në të cilin dele-

gatët me aklamacion, pa kundërkandidat dhe asnjë votë kundër, rizgjodhën edhe për një mandat kryetar

të kësaj partie prof. dr. Ferid Aganin. Në fjalën e tij kreu i PD-së ka falënderuar për mbështetjen e gjithë dele-

gatët dhe anëtarësinë që gjatë kësaj periudhe i qëndruan afër nëpër sfidat që kaloi partia.

Flet për "Epokën e re", Fazli Hoxha

Projekti 'Bashkë për shtetin' po

Anëtari i Kryesisë së Nismës Socialdemokrate dhe kandidati për deputet nga radhët e koalicionit Nisma-AKR-PD, Fazli Hoxha, ka bërë me dije se ky koalicion i ka hyrë garës zgjedhore me synimin për të dalë fitues. Ai ka treguar se projekti 'Bashkë për shtetin' po gjen mbështetje kudo në Kosovë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se fuqia e Nismës në Gjakovë dhe në gjithë Kosovën do të shihet më 6 tetor. Sipas Hoxhës, koalicioni Nisma-AKR-PD do të jetë përcaktues për formimin e qeverisë së ardhshme. Ai ka thënë se pas 6 tetorit, Kosovës i duhet një qeveri reformatore pasi, sipas tij, përfundimi i procesit të dialogut do të jetë një prej vendimeve të mëdha të qeverisë së re. Në këtë intervistë Hoxha ka folur edhe për përdorimin e veturave zyrtare në fushatë, duke e vlerësuar shembull të keq



EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Anëtari i Kryesisë së Nismës Socialdemokrate dhe kandidati për deputet nga radhët e koalicionit parazgjedhor Nisma-AKR-PD, Fazli Hoxha, ka thënë të hënën se kjo parti si asnjëherë më parë hyn e fuqishme në zgjedhjet e parakohshme, me synim për të dalë fituese së bashku me partnerët e vet - AKR-në dhe PD-në. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se fuqia e Nismës në Gjakovë dhe në gjithë Kosovën do të shihet më 6 tetor. "Projekti 'Bashkë për shtetin' po gjen mbështetje kudo në Kosovë sepse rrugë tjetër që e çon Kosovën përpara nuk ka përveç frymës së Nismës Socialdemokrate. Rreth saj po bashkohen njerëz me energji pozitive në shërbim të vendit", është shprehur Hoxha ai, duke shtuar se koalicioni Nisma-AKR-PD do të jetë përcaktues për formimin e qeverisë së ardhshme. "Ne jemi të bindur se do të jemi fitues si koalicion sepse e kemi kandidatin më të mirë për kryeministër. Nëse ndodh e kundërta, sigurisht se ne do të jemi koalicioni përcaktues për formimin e qeverisë së ardhshme", ka thënë Hoxha.

Ai ka vlerësuar se gjatë qeverisjes dyvjeçare në ministritë e drejtuar nga zyrtarët e Nismës janë bërë punë të mëdha të cilat kanë ndikuar në mirëqenien e qytetarëve. "Mund t'ju them se ministrat tanë janë dalluar për punë në qeverinë Haradinaj", ka deklaruar Hoxha. Ai ka thënë se pas 6 tetorit Kosovës i duhet një qeveri reformatore dhe, sipas tij, përfundimi i procesit të dialogut

do të jetë një prej vendimeve të mëdha të qeverisë së re. Në këtë kontekst, ai ka thënë se Nisma do të luajë rol konstruktiv si në pozitë, po ashtu edhe në opozitë

"Epoka e re": Z. Hoxha, më 6 tetor do të mbahen zgjedhjet parlamentare. Sa jeni përgatitur si parti që të hyni në këto zgjedhje?

Hoxha: Nisma Socialdemokrate ka bërë të gjitha përgatitjet sa i përket organizimit të brendshëm si subjekt politik për zgjedhjet e 6 tetorit qoftë edhe me formimin e shtabeve zgjedhore nëpër degë, po ashtu edhe Forumi i Gruas së Nismës dhe ai i Rinisë janë mobilizuar që në këto zgjedhje Nisma të ketë një fitore më të madhe. Pra, angazhimi po ndodh në të gjitha strukturat e Nismës. Ka disa ditë që kryetari, njëherësh kandidati për kryeministër i koalicionit Nisma-AKR-PD, Fatmir Limaj, ka dalë në terren duke takuar strukturat e partisë për ta përcjellë mesazhin e mobilizimit të anëtarësisë për zgjedhjet parlamentare të 6 tetorit. Unë personalisht kam marrë pjesë pothuajse në shumicën e këtyre takimeve që z. Limaj ka mbajtur me struktura nëpër komuna dhe po shihet se fryma e socialdemokracisë është rritur në çdo qytet. Nisma Socialdemokrate si asnjëherë më parë këtë herë po hyn e fuqishme në zgjedhje me synimin që të dalë fituese me partnerët e vet - AKR-në dhe PD-në.

"Epoka e re": Ju jeni edhe kryetar i Degës së Nismës në Gjakovë dhe në këto zgjedhje jeni edhe kandidat për deputet. Cila është gjendja e Nismës në këtë qytet?

Hoxha: Nisma në Gjakovë tanimë

është shtrirë me struktura në gjithë komunën, në çdo lagje dhe në çdo fshat. Këtë vit kemi mbushur pesë vjet të themelimit dhe kemi një anëtarësi të madhe në Gjakovë. Tanimë nuk mund të konsiderohemi parti e vogël në Gjakovë qysh na kanë parë në fillim kundërshtarët politikë. Kemi tre asamblistë dhe jemi pjesë e qeverisjes në nivel lokal. Kontributi i Nismës qoftë në Kuvendin Komunal dhe atë të qeverisjes ka qenë i jashtëzakonshëm në shumë projekte të cilat i kemi shtyrë përpara. Gjithashtu, nga qeverisja në nivelin qendror, ku Nisma ka pasur përgjegjësi në tri ministri, përkrahja për Gjakovën ka ardhur në shumë projekte. Qytetarët e Gjakovës më së miri e dinë kontributin tim si kryetar dege, ekipit tim të udhëheqjes së Nismës dhe të Nismës për Gjakovën. Në zgjedhjet e 6 tetorit, pos meje, kandidatë për deputetë nga Gjakova janë edhe Erjona Rama, Violeta Dema, Luan Dinaj dhe Edmond Dushi. Projekti 'Bashkë për shtetin' po gjen mbështetje kudo në Kosovë sepse rrugë tjetër që e çon Kosovën përpara nuk ka

përveç frymës së Nismës Socialdemokrate. Rreth saj po bashkohen njerëz me energji pozitive në shërbim të vendit. Fuqia e Nismës në Gjakovë dhe në gjithë Kosovën do të shihet më 6 tetor

"Epoka e re": Keni qenë edhe këshilltar i ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale. A mendoni se Nisma ka bërë sa duhet me ministritë që ka drejtuar, edhe pse dy ish-ministra tashmë s'i keni në parti?

Hoxha: Kjo puna e largimit të individëve nuk duhet të merret tragjike, se ndodh në çdo parti politike. Dikush shkon e dikush vjen, partia edhe pranon njerëz, por edhe mund të largojë. Në Nismën Socialdemokrate kanë ardhur me mijëra anëtarë dhe mediet asnjëherë nuk pyesin për aderime, por vetëm për dy ose tri largime që kanë ndodhur. Ka anëtarë që, ndoshta, kanë dhënë angazhim shumë më të madh për Nismën dhe nuk janë bërë ministra e as zëvendësministra dhe sot janë ende pjesë e rrugëtimit politik të Nismës, sepse kanë besuar dhe besojnë në vizionin e liderit Fatmir Limaj. Pra, po dua të them se ka pasur

të atillë që nuk kanë punuar për veten, por për partinë, pavarësisht nëse nuk janë shpërblyer me ndonjë pozitë në qeveri ku Nisma ka qenë pjesë e saj. Nisma sot është shumë e fuqishme dhe e mobilizuar. Sa i përket punës së Nismës në ministritë që ka drejtuar, mund të flas me kompetencë për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ku është bërë një punë shumë e madhe sa iu përket politikave sociale. Edhe në Ministrinë e Arsimit dhe të Tregtisë ka pasur punë të pandalshme që kanë ndikuar në mirëqenien e qytetarëve. Mund t'ju them se ministrat tanë janë dalluar për punë në qeverinë Haradinaj.

"Epoka e re": Z. Hoxha, prej se janë shpallur zgjedhjet ka nisur fushata para kohe dhe partitë që janë pjesë e qeverisë në largim, zyrtarë të këtyre partive po i përdorin veturat zyrtare për tubime partiake, një shembull ky që është kritikuar edhe nga shoqëria civile. Ka edhe zyrtarë të Nismës që janë zëvendësministra e ministra që i përdorin veturat zyrtare?

Hoxha: Unë mund të flas vetëm për veten. Kur jam emëruar

mbështetet në gjithë Kosovën



këshilltar nuk kam pranuar të kem veturë zyrtare edhe pse më ka takuar. Për dy vjet sa ka zgjatur kjo qeveri kam përdorur

veturën time private. Këtë mund ta vërtetoni edhe në Ministri të Punës. Përdorimi i veturave zyrtare në fushatë nuk

është diçka e re, kjo është bërë më herët edhe nga qeveritë e kaluara. Po të pyetesha unë, asnjëri nuk do të duhej ta

përdorte veturën zyrtare në aktivitete partiake, sepse nuk është shembull i mirë, por kjo po shihet se po ndodh nga të gjitha partitë. Nuk mund të thotë sot dikush në opozitë se 'këta po i keqpërdorin veturat zyrtare' kur edhe vetë ishin në pushtet e kanë bërë një gjë të tillë. Nuk duhet të keqpërdoren taksat e qytetarëve.

"Epoka e re": Kandidati për kryeministër nga koalicioni juaj, Fatmir Limaj, u ka bërë thirrje kundërkandidatëve për një debat televiziv. Mendoni se mund të ndodhë?

Hoxha: Si ide është shumë e mirë, sepse qytetarët e kanë mundësinë ta shohin njohurinë e të gjithë kandidatëve që garojnë për kryeministër. Pra, do të ishte diçka e mirë të ndodhte një debat i përbashkët mes kandidatëve për kryeministër, por unë mendoj se nuk mund të ndodhë sepse përplasjet mes liderëve janë aq të mëdha sa që hezitojnë të përballen në një debat. Z. Limaj nuk e ka problem këtë gjë, sepse po ta kishte problem nuk do ta kishte propozuar. Opinioni e di se z. Limaj është një lider bashkues. Në shumë raste të rëndësishme për vendin e ka treguar vetën.

"Epoka e re": Çfarë qeverie prisni pas 6 tetorit?

Hoxha: E ka potencuar edhe lideri ynë, se pas 6 tetorit Kosovës i duhet një qeveri reformatore. Vendin e presin shumë tema të mëdha. Një prej tyre është dialogu me Serbinë që kërkon një përmbyllje të këtij procesi.

Prioritete të tjera të Nismës në qeverinë e ardhshme, pos dialogut, janë edhe politika e jashtme, bujqësia, zhvillimi ekonomik dhe paketa sociale. Prandaj, Kosovës i duhet një lider si z. Limaj që u bënë ballë këtyre temave, një lider që është bashkues, një lider që nuk e lë vendin në bllokadë vetëm për kalkulime partiake. Më 6 tetor qytetarët duhet t'ia japin besimin kandidatit tonë për kryeministër, z. Limaj.

"Epoka e re": Çka nëse nuk e merr koalicioni Nisma-AKR-PD besimin e qytetarëve për të udhëhequr vendin? Cili do të jetë qëndrimi i Nismës për këto tema? A do të bëheni pjesë e qeverisë?

Hoxha: Ne jemi të bindur se do të jemi fitues si koalicion sepse e kemi kandidatit më të mirë për kryeministër. Nëse ndodh e kundërta, sigurisht se ne do të jemi koalicioni përcaktues për formimin e qeverisë së ardhshme.

Z. Limaj para disa ditësh u ka shkruar një letër të gjithë kandidatëve për kryeministër sa i përket dialogut me Serbinë. Nisma Socialdemokrate pas zgjedhjeve të 6 tetorit do të vazhdojë të jetë pjesë konstruktive e politikës shtetërore të Kosovës, që së bashku me miqtë ndërkombëtarë të përmbillet dialogu me Serbinë. Pra, pa marrë parasysh nëse do të jemi pjesë e qeverisjes apo si forcë politike opozitare, interesi i Kosovës është mbi të gjitha. Nisma Socialdemokrate do ta japë kontributin e vet në përmbylljen e këtij procesi.

Gjenerata e parë e kadetëve të FSK-së feston 10-vjetorin e diplomimit

Prishtinë, 23 shtator (ER) - Kadetët e gjeneratës së parë të Qendrës për Studime Universitare (QSU), tanimë oficerë të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), kremtuan sot 10-vjetorin e diplomimit të kësaj gjenerate. Në këtë ceremoni të pranishëm ishin: ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha, zëvendësministri Burim Ramadani, komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), gjeneralleteniant Rrahman Rama, ushtruesi i detyrës i sekretarit të përgjithshëm Faruk Geci, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral Irfete Spahiu, gjeneralë të FSK-së, ish-komandantë të QSU-së, si dhe oficerë dhe

kadetë të FSK-së. Me këtë rast, të pranishmëve me një fjalë rasti iu drejtua komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjeneralleteniant Rrahman Rama. "Forca e Sigurisë e Kosovës me sukses ka arritur të zhvillojë sistem të rekrutimit, shkollimit dhe trajnimit të kuadrove të reja dhe se pikërisht sistemi i tillë serioz dhe i përkushtuar ka bërë që FSK-ja sot të krenohet me oficerët e rinj, si garantuese e vazhdimësisë së suksesshme të institucionit tonë. Qendra për Studime Universitare e FSK-së së shpejti do të jetë ndërkombëtare, ku do të kenë mundësi të shkollohen edhe kadetë nga shtetet mike dhe partnere", është shprehur gjeneral Rama.



Komuna e Rahovecit binjakëzohet me dy komuna italiane



RAHOVEC, 23 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka nënshkruar dy deklarata që kanë të bëjnë me binjakëzimin e Komunës së Rahovecit me dy komuna të Italisë, Frascineto dhe Civita. Në ceremoninë e nënshkrimit të pranishëm ishin Angelo Catapano nga Komuna e Frascinetos, Alessandro Tocci nga Komuna Civita dhe ministrja e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Adriana Hoxhiq. Në dokumentin e nënshkruar në mes të Komunës së Rahovecit dhe dy komunave Italiane, Frascineto dhe Civita, thuhet se palët nënshkruese të deklaratës do të hulumtojnë dhe harmonizojnë marrëdhënie të ndryshme ekonomike si dhe mundësinë e bashkëpunimit në fushën e

zhvillimit rajonal dhe rural, në ekonomi, bujqësi, programe, fonde dhe projekte të BE-së, turizëm, kulturë, sport, arsim, shkencë dhe fusha të tjera për të cilat palët nënshkruese mund ta shprehin interesimin e tyre dhe të krijojnë kushte për thellimin e mbështetjes së marrëdhënieve miqësore të administratës rajonale, vendbanimeve dhe vetëqeverisjes lokale në të dyja anët.

Po në deklaratën e nënshkruar thuhet se palët nënshkruese do të fillojnë elaborim të hollësishëm të përmbajtjes së Marrëveshjes së Bashkëpunimit, e cila, në pajtim me ligjin e brendshëm të secilës palë, do të miratohet nga autoritetet kompetente të palëve nënshkruese të kësaj deklarate.

Inspektorët kërkojnë nga Hidroregjioni Jugor rregullimin e dëmeve që kanë bërë në rrugët e Malishevës

MALISHEVË, 23 SHTATOR (ER) - Të hënën është mbajtur mbledhja e rregullt e Këshillit të Drejtorëve të qeverisë komunale në Malishevë, e drejtuar nga kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ndërsa në këtë mbledhje, krahas raportimeve, është bërë me dije se disa rrugë në territorin e Komunës së Malishevës janë dëmtuar si pasojë e ndërhyrjeve nga njësia për menaxhimin e ujërave "Hidroregjioni Jugor". Sipas Drejtorisë së Inspektoratit dhe asaj të Urbanizmit, njësia e "Hidroregjionit Jugor" në Malishevë gjatë intervenimeve të ndryshme në riparimin e sistemit të ujësjellësit apo kanal-

izimit ka dëmtuar rrugët apo trotuaret dhe nuk i ka kthyer në gjendjen e mëparshme pas kryerjes së punimeve. Për këtë qëllim i është kërkuar kësaj kompanie që rrugët apo trotuaret e dëmtuara t'i kthejë në gjendjen e mëparshme. Në këtë mbledhje edhe Drejtoria e Shërbimeve Publike ka njoftuar se kanë filluar përgatitjet për mirëmbajtjen e rrugëve dhe të trotuareve gjatë sezonit të dimrit në qytet dhe në të gjitha rrugët në vendbanimet e Komunës së Malishevës.

Sa i përket realizimit të projekteve, sipas Drejtorisë së Urbanizmit, janë duke u realizuar në terren disa nga projektet që kanë të



bëjnë me infrastrukturën rrugore dhe të sistemeve të kanalizimeve. Po në këtë mbledhje zyrtari komunal i shërbimeve publike, Naser Morina, ka raportuar para

qeverisë komunale për trajnimin e kryer në Japoni dhe certifikimin e tij në fushën "Avancimi i teknologjive të menaxhimit të mbeturinave inerte" dhe i njëjti

ka thënë se përvojat e marra në shtetin japonez do të mundohet t'i zbatojë edhe në Komunën e Malishevës duke iu përshtatur kushteve tona.



Bali Muharremaj i bashkohet fushatës së vetëdijesimit në trafik

SUHAREKË, 23 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, i është bashkuar të hënën fushatës së vetëdijesimit në trafik. Qëllimi i këtij projekti është ngritja e kujdesit dhe

vetëdijesimit të pjesëmarrësve në trafikun rrugor si të drejtuesve të automjeteve, po ashtu edhe të këmbësorëve në mënyrë që mos të pësohen lëndime në rastin eventual të aksidenteve të trafikut.

Gjilani shpërndan mekanizëm bujqësor për 60 fermerë

GJILAN, 23 SHTATOR (ER) - Drejtoria e Bujqësisë e Komunës së Gjilanit ka shpërndarë të hënën mekanizëm bujqësor për 60 fermerë, vlera e të cilëve është 53 mijë euro. Drejtori i Bujqësisë, Ramiz Ramadani, ka deklaruar se ky është viti i gjashtë që komuna e udhëhequr nga Lutfi Haziri shpërndan këtë pako. "Është viti i gjashtë i qeverisjes që e promovojmë këtë projekt, duke e vlerësuar rëndësinë e mekanizmit bujqësor. Nga kjo pako mbështetëse përfitojnë 20 fermerë me spërkatëse 440 litërshë, 10 fermerë përfitojnë rotofreza, 10 të tjerë përfitojnë



piajtore me 24 disqe, 10 fermerë kosa rotative, ndërsa 10 fermerë të tjerë përfitojnë grumbulluese të sanës. Për pak ditë, edhe dhjetë fermerë do të furnizohen me makina për mbjellje të misrit. Pra, janë 70 pajisje mekanizimi", ka thënë Ramadani.

Pasi e ka falënderuar kryetarin Haziri për mbështetjen sistematike ndaj sektorit të bujqësisë, Ramadani ka theksuar se krahas këtij aktiviteti Drejtoria për Bujqësi e ka të hapur edhe thirrjen për aplikim për farë të grurit, duke shtuar se mekanizimi bujqësor do ta krijojë mundësinë e punimit cilësor të

tokës e rritjes së rendimentit. Ndërsa fermeri nga Pogragja, Ismajl Rexhepi, e ka falënderuar kryetarin Haziri për mbështetjen në mekanizim, duke thënë se ky është një lehtësim i madh për të për punimin e tokës.

Instituti i Shëndetësisë: Ndotja e ajrit po kërcënon shëndetin e popullatës

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se ndotja e ajrit në vendin tonë është duke e kërcënuar shëndetin e qytetarëve. Ky institut nëpërmjet një njoftimi ka theksuar se në sezonin e dimrit qyteti i Prishtinës po zhytet në smog, gjë që paraqet ndotje të kom-

binuar të ajrit me gazra dhe aerosole i cili vërehet gjithandej. Ekspertët e Institutit Kombëtar paralajmërojnë se nëse nuk merren masa urgjente do të ketë efekte negative në dëmtimin e shëndetit dhe rritjen e vdekshmërisë nga të gjitha shkaqet, e sidomos nga sëmundjet kardiovaskulare dhe respiratore.

binuar të ajrit me gazra dhe aerosole i cili vërehet gjithandej.

Ekspertët e Institutit Kombëtar paralajmërojnë se nëse nuk merren masa urgjente do të

ketë efekte negative në dëmtimin e shëndetit dhe rritjen e vdekshmërisë nga të gjitha shkaqet, e sidomos nga sëmundjet kardiovaskulare dhe respiratore.



Slogani i KQZ-së për zgjedhjet e 6 tetorit: 'TREGO FUQINË TËNDE, VOTO'

'Trego fuqinë tënde, voto' është slogani i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për zgjedhjet parlamentare të 6 tetorit i cili është miratuar në mbledhjen e së hënës. Ndërsa kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, ka reaguar pas publikimit të videos nga diaspora lidhur me keqpërdorimin e votave, duke thënë se votimi jashtë Kosovës mund të cenohet lehtë. Po të hënën drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka mbajtur takim me menaxhmentin policor të nivelit qendror dhe atij lokal lidhur me angazhimin e policisë për zbatimin e planit policor për "Zgjedhjet e parakohshme parlamentare - 2019"



EPOKA E RE

Faton DERMAKU

PRISHTINË, 23 SHTATOR - "Trego fuqinë tënde, voto" është slogani i ri i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit që është aprovuar të hënën.

Anëtarja e KQZ-së nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Nazlie Bala, ka deklaruar se Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik ka propozuar sloganin e ri për KQZ-në i cili

nuk ngjason me sloganet e subjekteve politike. "Slogani i ri i propozuar nga Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik është: 'Trego fuqinë tënde, voto'", ka treguar ajo. Kurse përfaqësuesi i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në KQZ, Ilir Gashi, ka kërkuar garanci se slogani i ri nuk ngjason me sloganin e ndonjë subjekti politik. "A ka garanci që slogani i ri që na është sjellë koincidon me një slogan të një subjekti tjetër. Unë s'kam qenë pjesë e këtij Këshilli kur është

vendosur për sloganin që është aktualisht dhe kur ka ardhur unanimisht e kemi votuar", është shprehur ai.

Ndërkaq Adnan Rustemi nga Lëvizja Vetëvendosje (LV) ka tërhequr vërejtjen që në KQZ të mos silltet beteja politike, në mënyrë që kjo e fundit të mos rrëshqasë në asnjë anë, siç është slogani. Slogani i deritanishëm i KQZ-së ishte "Votojmë për të ardhmen tonë", slogan ky

që u konsiderua i ngjashëm me atë të PDK-së që është "Ndërtojmë të ardhmen, për ty dhe shtetin".

Ndërsa kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, ka reaguar pas publikimit të videos nga diaspora lidhur me keqpërdorimin e votave. Ajo ka thënë se duhet argumentuar nëse kjo video është e vërtetë sepse, sipas saj, votimi jashtë Kosovës mund të cenohet lehtë. "Është shqetësuese. Unë vazhdimisht kam theksuar se votimi jashtë Kosovës ka një integritet të cenusur dhe mund të cenohet shumë lehtë, se është votë e pambrojtur. Ne si KQZ bëjmë të gjitha ato çka na lejon ligji. E bëjmë vërtetimin e dokumenteve të cilave iu bashkëngjiten këtyre votave dhe a është në listë të votuesve, ndërsa çështja e manipulimit mund të jetë objekt i shqyrtimit nga ana e policisë dhe prokurorisë. Kur të vërtetohet, ne atëherë i pranojmë ato të cilat vijnë në mënyrë të rregullt nga diaspora", ka thënë Daka.

Ditë më parë në medie është publikuar një video ku shihen disa persona duke mbushur mbi 50 fletëvotime. Ndërsa drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka mbajtur takim me menaxhmentin policor të nivelit qendror dhe atij lokal lidhur me angazhimin e policisë në zbatimin e planit policor për "Zgjedhjet e parakohshme parlamentare - 2019". Me këtë rast, Qalaj ka thënë se krijimi i një klime të qetë dhe të sigurt për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës si dhe mbajtja e rendit, qetësisë dhe sigurisë publike në vend para, gjatë dhe pas procesit të zgjedhjeve, është primare për Policinë e Kosovës. Ai ka bërë me dije se Policia e Kosovës do të angazhojë një numër të mjaftueshëm të zyrtarëve policorë të profileve të ndryshme që iu përkasin njësiteve të ndryshme brenda Policisë së Kosovës, si dhe ka marrë masa shtesë duke caktuar edhe koordinatoret të Policisë me KQZ-në dhe institucionet e tjera të angazhuara në këtë proces.



ZGJEDHJET
E PARAKOHSHME PËR
KUVENDIN E KOSOVËS **2019**

TREGO FUQINË TËNDE - VOTO!

Ambasadori i Britanisë viziton Doganën

PRISHTINË, 23 SHTATOR (ER) - Drejtori i përgjithshëm i Doganës së Kosovës, Bahri Berisha, ka prituri të hënën në takim ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar,

Nicholas Abbott. Gjatë takimit u diskutuan çështje tregtare në mes të dy vendeve tona si dhe përkrahja e madhe që Britania ka dhënë për zhvillimin e Doganës së Kosovës.

Berisha ka informuar ambasadorin lidhur me të arriturat e Doganës si dhe për përparimin e arritur në fushat e ndryshme duke përfshirë luftimin e krimit transkufitar.

Gjithashtu, ambasadori u njoftua edhe me të arriturat në 20-vjetorin e themelimit të Doganës, për të cilën Dogana e Britanisë ka dhënë kontribut të madh.



Agjencia Kadastrale, vizitë zyrtare në Seul

PRISHTINË, 23 SHTATOR (ER) - Një delegacion gjithëpërfshirës i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, i prirë nga kryeshefi ekzekutiv Avni Ahmeti, i përkrahur nga bashkëpunëtorë nga fusha e kadastrës dhe TI-së, me ftesë të Bankës Botërore është duke marrë pjesë në koherencën ndërkombëtare për përfshirjen e politikave të gjelbra në implementim të projekteve të ndryshme, përfshirë edhe ato kadastrale dhe gjeohapësinore, e cila do të mbahet në Seul të Republikës së Koresë së Jugut mes datave 22 shtator - 27 shtator.

Konkretisht tri ditët e para të aktivitetëve kanë për qëllim participimin e delegacionit të AKK-së në punëtori profesionale të organizuara nga institucione publike të interesit, respektivisht nga agjencitë përgjegjëse për kadastrë, regjistra pronësorë, hartografi, infrastrukturë të informacioneve hapësinore, adresa etj.

Qëllimi i takimeve është informimi mbi kontributin e këtyre institucioneve në pro-

movimin, krijimin dhe implementimin e politikave të gjelbra si komponentë të rëndësishëm të aktivitetëve të tyre.

Gjatë punësive të ditës së parë ekspertët e Agjencisë participuan në prezantimin e Agjencisë për Pronë dhe Kadastrë të Republikës së Koresë (LX) dhe të Ministrisë së Brendshme dhe të Sigurisë, respektivisht Agjencisë Shtetërore për Shoqëri të Informacionit, ku përmes diskutimeve interaktive u prezantua mandati, struktura organizative dhe përgjegjësitë e AKK-së si dhe u prezantuan reformat e planifikuara në kadastrë që ndërlihen me ristrukturimin e sistemit kadastral, respektivisht vertikalizimin e të njëjtit duke futur zyrat kadastrale komunale nën kompetenca të AKK-së, pastaj u prezantuan ndryshimet dhe plotësimet e akteve nënligjore që pritet të hyjnë në fuqi e që së bashku me shërbimet e produktet e krijuara, do të krijojnë bazën teknike dhe ligjore për ofrimin e produkteve "online".

Ekipi i AKK-së u informua me të



shkuarën, gjendjen aktuale dhe vizionit e administrimit të tokës dhe e-Querisjes në përgjithësi dhe ofrimin të produkteve dhe shërbimeve në veçanti.

Organizatore e punësive është Banka Botërore, ndërsa pjesëmarrëse janë dhjetëra institucione shtetërore nga fusha e pronës dhe banimit, ambientit,

transportit e urbanizmit e ngjashëm. Konferenca kryesore "Korean Green Growth Conference" do të mbahet më 26 dhe 27 shtator.

Lluka: Franca, partnere e rëndësishme në zhvillimin e Kosovës



PRISHTINË, 23 SHTATOR (ER) - Ministri i Zhvillimit Ekonomik në detyrë, Valdrin Lluka, ka pritur të hënën në takim ambasadorën e re të shtetit francez, Marie Christine Butel, e cila ishte e shoqëruar me drejtoreshën e Zyrës Rajonale të Thesarit Francez, me seli në Sofje, Florence Dobelle, të cilën e njoftoi për zhvillimet ekonomike në Kosovë, për ecurinë e projekteve franceze në Kosovë si dhe për shtimin e partneritetit ekonomik mes dy vendeve. Gjatë takimit ministri Lluka ka konfirmuar gatishmërinë e Republikës së Kosovës për ta vazhduar rritjen e bashkëpunimit ekonomik të dy vendeve nëpërmjet rritjes së investimeve direkte të investitorëve francezë në Kosovë dhe promovimit të produkteve kosovare në Francë. Në takim, gjithashtu, është diskutuar edhe ecuria e imple-

mentimit të projektit për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza për qytetin e Prishtinës, Fushë-Kosovës dhe Obiliqit, projekt ky në vlerë prej 86 milionë eurosh.

Lluka shprehu mirënjohje të thella për kontributin e Francës dhënë për Kosovën dhe përkushtimin për zhvillimin ekonomik të vendit tonë.

Nga ana tjetër, drejtoresha Dobelle falënderoi ministrin Lluka për bashkëpunimin e deritashëm dhe shprehu gatishmërinë për ta rritur bashkëpunimin edhe më tej në mbështetje të zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Edhe ambasadorja Christine Butel i ka përcjell ministrit Lluka angazhimin dhe rolin e Francës për ta përkrahur Kosovën në të gjitha proceset që ndihmojnë Kosovën në zhvillimin ekonomik.

Shënohet dita e vjeljes së mollës

ISTOG, 23 SHTATOR (ER) - Me rastin e ditës tradicionale të vjeljes së mollës, kandidati për deputet i Partisë Demokratike të Kosovës nga Komuna e Istogut, Lulzim Shoshi, ka vizituar të hënën fshatin Kovragë, ku u mirëprit nga banorët e

këtij fshati. "Kultivuesit e mollës i përgëzoja për punën e bërë dhe u urova suksese dhe bereqet. Si drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë në Istog çdoherë jam munduar të jem afër kultivuesve, bujqve, bletarëve dhe të gjithë atyre që merren me

këtë lëmë. Kovraga është e njohur për mollë gjë që, pos përfitimeve ekonomike dhe sociale, është edhe imazh i Istogut që na motivon për përkrahje edhe më tutje", ka thënë Shoshi. Ai ka shtuar se shumë herë në mungesë të sig-

urimeve bujqësore bujqit tanë janë dëmtuar financiarisht. "Në mandatin time në të ardhmen do të kërkoj vazhdimisht dhe do të bëjmë të pamundurën që të sigurohen produktet tona bujqësore", ka deklaruar Shoshi.



Veseli: Brenda dy vjetësh çdo familje do t'i marrë fletët poseduese për pronat e veta

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), njëherësh kandidat për kryeministër, Kadri Veseli, ka treguar më hollësisht për projektin e vet për legalizimin e përsheptuar të ndërtimeve pa leje. Veseli ka thënë se sot kemi mbi 352 mijë ndërtesa dhe banesa pa fleta poseduese në Kosovë, që bllokojnë mbi 10 miliardë euro

kapital, ndërsa me bazën aktuale ligjore, në procesin e legalizimit janë përfshirë vetëm 8 600 ndërtime pa leje. Me ritmin e deritashëm, Veseli ka thënë se Kosovës do t'i duhen më shumë se 75 vjet për ta zgjidhur këtë problem, por ai planifikon ta bëjë për vetëm dy vjet. "Një ndër pikat kryesore të Planit Kundër Korrupsionit është legalizimi i përsheptuar brenda dy vjetësh i të gjitha ndërtimeve pa leje, që nuk prekin pronat publike apo interesin publik. Sot kemi

mbi 352 mijë ndërtesa dhe banesa pa fletë poseduese në Kosovë, që bllokojnë mbi 10 miliardë euro kapital. Me bazën aktuale ligjore, në procesin e legalizimit janë përfshirë vetëm 8600 ndërtime pa leje dhe me këtë ritëm duhen më shumë se 75 vjet për ta zgjidhur këtë problem. Prandaj ne do ta ndryshojmë këtë kornizë ligjore, duke bërë që qytetarët të paguajnë vetëm një euro për metër katror, ndërkohë që do lirohen tërësisht nga pagesa familjet që u përkasin

kategorive të veçanta sociale. Do të krijojmë një agjenci të specializuar të përkohshme (Agjencia e Trajtimit të Ndërtimeve Pa Leje - ATNPL), e cila do t'i ofrojë shërbimet nën një çati për ta përmbyllur procesin brenda dy vjetësh, duke bashkëvepruar me komunat dhe koordinuar veprimet me institucionet e ndryshme shtetërore", ka thënë Veseli. Ai ka theksuar se kjo nismë do t'i japë fund informalitetit në

sektorin e patundshmërisë, duke i dhënë shtytje të fuqishme sektorit të ndërtimit, i cili zë 15 për qind të bruto prodhimit vendor dhe mundëson 20 për qind të punësimit sot në Kosovë. "Por, më e rëndësishmja është që kjo nismë do të mundësojë fluksin më të madh të kapitalit që ka pasur ndonjëherë ekonomia jonë, duke futur në qarkullim miliardë euro që do të përkthehen në rritje të fuqisë blerëse dhe në investime të reja", ka thënë Veseli.



Drejtori Murtezi ka vizituar Agjencinë e të Hyrave dhe Doganës në Britaninë e Madhe

PRISHTINË, 23 SHTATOR (ER) - Me ftesë të Ambasadës së Britanisë së Madhe, një delegacion nga Administrata Tatimore e Kosovës, i përbërë nga drejtori i përgjithshëm i

ATK-së, Ilir Murtezi, dhe disa nga bashkëpunëtorët e tij, kanë qëndruar në vizitë zyrtare në Agjencinë e të Hyrave dhe Doganës në Britaninë e Madhe, me qëllim

të marrjes së përvajave nga autoritetet britanike për rritjen e kapaciteteve në njësinë e inteligjencës financiare në ATK si dhe për marrjen e praktikave në fushën e luftimit

të evazionit dhe shmangies tatimore. Kjo vizitë është realizuar në kuadër të komponentit të bashkëpunimit që kemi me Ambasadën e Britanisë së Madhe.



ADEM DEMAÇ - BACA, SHASHIVAR MAKOLLI - QALI DHE BAJRUSH BEHRAMI - BALI!



**Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA**

Preteksti i shkrimit: Po shkruaj për tre njerëz të mëdhenj, për tre patriotë të jashtëzakonshëm, për tre frymëzues dhe zbatues të luftës së paepur të shqiptarëve për çlirim, liri dhe bashkim kombëtar. Po shkruaj për tre engjëj mbrojtës të shqiptarisë, për tre yje që gjithmonë e kanë ndriçuar rrugën e shqiptarëve drejt lirisë dhe pavarësisë. Po shkruaj për tre dishepuj që, pavarësisht prej reziqëve dhe sakrificave që i kanë bërë, personalisht dhe familjarisht asnjëherë nuk i janë larguar rrugës së lirisë dhe bashkimit kombëtar. Po shkruaj sepse në zemër po ndiej një mungesë për ta, personalisht dhe familjarisht, ndonëse shpirtat i kemi të bashkuar, që nga koha kur u njohëm, edhe tash, sikur që do të jetë kështu deri në amshim kur, në botën e përtejme edhe mund të takohemi, nëse e meritoj të takohem me ta, qoftë edhe për një çast të vetëm. Ky shkrim në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si shkrim që iu kushtohet atyre që kanë vdekur, si një përkujtim të stilit in memoriam sepse ata që i shërbejnë njerëzimit, kombit dhe luftës për liri, bëhen pjesë e përjetësisë e që nuk është diçka kalimtare. Kosova, shqiptarët dhe Shqipëria sikur edhe trojet ku jetohej shqip, frymohet shqip, ëndërrohet shqip dhe vdiset shqip, duke i kënduar lirisë, sot kanë nevojë për këta tre yje të shqiptarisë si dhe yjeve të tjera të qiellit dhe nënqiellit shqiptar! Adem Demaçi - Baci, Shashivar Makolli - Qali, Bajrush Behrami - Bali dhe të gjithë dëshmorët e kombit e kanë një datëlindje, por jo edhe datë vdekjeje sepse e kanë fituar përjetësinë.

Adem Demaçi - Baci: Nëse Hasreti Ademi merret si embrion i formimit të njerëzimit nga i cili u bënë thujja 9 miliardë bijë dhe bija të tij, Adem Demaçi - Baci ishte dhe mbeti frymëzimi dhe kuptimi i luftës dhe

sakrificës së popujve të robëruar për liri, në përgjithësi dhe të shqiptarëve, në veçanti! Adem Demaçi - Baci ishte dhe mbeti Komandant Legjendar Politik i shqiptarëve në luftë për liri sikur që ishte i tillë në planin ushtarak, Komandanti Legjendar, Adem Jashari! Këta e vulosën dhe e shkruan, njëri me sakrificë sublimë duke kaluar 30 vjet në llogoret e ish-Jugosllavisë, në kushte ku dinjiteti njerëzor e kishte humbur kuptimin e respektimit, qoftë edhe minimal, kurse Adem Jashari bëri një sakrificë, së bashku me familje, miqtë dhe bashkëluftëtarët e cila, deri atëherë nuk kishte ndodhur në asnjë vend të botës, gjatë tërë historisë njerëzore! Adem Demaçi - Baci, u tret, u shkri, u flijua dhe thjesht e tjetërsoi veten për çështje njerëzore dhe kombëtare. Adem Demaçi - Baci thoshte se çdo gjë ka çmim përveç lirisë për të cilën nuk ka çmim që nuk ia vlen të paguhet. Natyrisht se për të qëndruar në rrugën e Marathomakut për çlirim, liri dhe bashkim kombëtar duhen edhe disa çështje të tjera që janë të pandashme drejt lirisë; trimëria, vendosmëria, ndershmëria dhe gatishmëria për t'u sakrifikuar gjithmonë kur e kërkon atdheu dhe të cilat, gjithashtu, nuk kanë çmim, nuk blihen me pasurinë e tërë botës! Gjatë kohës sa qëndronte në llogoret e ish-Jugosllavisë për të cilat nuk thoshte se është dënim për të e lëre më vuajtje, por se është një përmbushje e detyrimit kombëtar dhe çmim që duhej paguar për çlirim, liri dhe bashkim kombëtar, llogoret e ish-Jugosllavisë i shndërroi në akademi politike dhe kombëtare për të gjithë të burgosurit shqiptarë dhe jo vetëm të atyre të dënuar për vepra politike. Kishte çaste kur nga pak ligështoheshim (njerëz jemi) sepse burgu është makinë për bluarje të njeriut, fizikisht dhe shpirtërisht, Adem Demaçi - Baci, me shembullin e vet na shkundte nga makthi i çastit e që këto çaste nuk përsëriteshin më! Edhe në kohën kur, fare pak qëndronte i "lirë" në burgun e quajtur Kosovë, shtëpia e tij, por edhe shtëpitë e të gjithë shqiptarëve që e donin lirinë, hiç këtu shërbëtorët e Serbisë dhe Jugosllavisë, bëhej amfiteatër ligjërimi për liri, çlirim dhe bashkim kombëtar. Pas daljes nga burgu në vitin

1990, Adem Demaçi - Baca e ka përkrahur Ibrahim Rugovën dhe me sugjerimet e Bacit edhe ne kemi votuar për Rugovën. Edhe unë, gjithashtu! Pasi u pa se Rugovën e mori lumi për faktin se nuk mernte përgjegjësi për udhëheqje të luftës, kur Jugosllavisë i dilte flaka, madje Rugova edhe e pengoi luftën e armatosur, u shua edhe përkrahja për Rugovën. Këta të Titos dhe Millosheviqit e që janë sot shumë aktivë në Kosovë, bënë përpjekje ta eliminonin Bacin duke e deklaruar se është marksist-leninist dhe enverist në kohën kur ishin ngjizur vetë nga shkërdhërja që ua kishin bërë, në shumë raste me pëlqimin e tyre, Titoja, Aleksandar Rankoviçi dhe Slobodan Millosheviçi. Për sa e njoh Adem Demaçin - Bacin, e mendoj se e njoh shumë mirë, ai ka qenë nacionalist i bindur dhe asgjë nuk e ka lidhur me marksizëm-leninizmin. Për enverizmin e ka dhënë përgjigjen gjatë vizitës së parë në Shqipëri; "më mirë do të ishte të vdisja në burg, me bindjen që e kam pasur për Shqipërinë se që e shoh në këtë gjendje...". Adem Demaçi - Baci ka qenë i dhënë pasionit pas muzikës klasike, polifonisë shqiptare dhe këngëve të vjetra qytetare. Kurrë në jetën që e kam kaluar me Bacin nuk e kam dëgjuar duke e kënduar Internacionalen komuniste apo ndonjë këngë proletare, por e kam dëgjuar duke kënduar këngët për Dedë Gjon Lulin, Mehmet Shpendin dhe Jakup Ferrin. Madje shumë herë thoshte se kur të niset në rrugën për përjetësi, ka dëshirë të përcillet me këngën e Dedë Gjon Lulit. Ngritja e flamurit kombëtar në trojet që me forcë iu morën shqiptarëve dhe Shqipërisë sikur edhe refreni: "Dedë Gjon Luli, i Malësisë së Madhe, hiç me vdekë nuk e kam gajle...", ishin preteksti dhe konteksti i shpirtit sakrifikuës që e bënin aq të madh Dedë Gjon Lulin para Bacit! Adem Demaçi - Baci ishte politikani dhe shqiptari më i nëpërkëmbur pas luftës në Kosovë. Nuk mbeti kush pa e denoncuar, edhe horrat e LDK-së sikur edhe morrat e krahut të luftës që, për një grusht pushteti pa shtet dhe një grusht parash të pista, ia pamundësuan çdo inkuadrim në politikë!

Ceremoninë mortore të Bacit ia bojkotuan horrat e LDK-së, të gjithë dhe pa përjashtim. Duket se horri gjithmonë mbetet horr dhe horrllëqet mund të mbulohen sa për t'u maskuar një horrllëk më i madh! Shqiptar Demaçi është djali i Bacit dhe i cili është rritur dhe zhvilluar nën hijen dhe peshën e një njeriu që lind vetëm një herë në 1000 vjet siç ishte Adem Demaçi - Baci. Ai, Shqiptari, përveçse është rritur nën hije të një babai të madh, ndonëse nuk është burgosur gjithmonë, ka jetuar në rrethana të një kërcënimi të vazhdueshëm. Është shkolluar dhe është një profesionist shembullor në fushën e mjekësisë. Përveçse është i përkryer si kirurg, ai ka trashëguar edhe një dell politik nga Baca Adem. Nëse i keni lexuar disa artikuj që i ka shkruar Shqiptar Demaçi, atëherë lehtësisht e kuptoni se ka një njohuri të gjerë dhe të thellë që e shpërfaq vetëm në çaste kur pakënaqësia e tij me proceset aktuale e kalojnë pikën e vlimit dhe të durimit. E ka një kryeneqësi sikur Baci, në ditët e hershme të angazhimit politik! Por, diçka jam fort i sigurt, se Shqiptar Demaçi kurrë dhe asnjëherë nuk do të bënte një veprim që do ta dëmtonte atdheun dhe kombin sepse, së fundi, dardha bie nën dardhë! Shqipi, kurrë dhe asnjëherë nuk do të pranonte që dikush të shkruajë në emër të tij dhe ai ta nënshkruajë këtë sepse e ka mendimin e vet dhe nuk i bindet askujt në këtë drejtim. Unë i kam sugjeruar që të mos hyjë në politikë, por ai ka thënë se do të merret ekskluzivisht me politikën shëndetësore dhe mjedisore ku edhe mund ta japë kontributin. U sulmua pse hyri në PDK. Po të hynte në LDK nuk do të bëhej e madhe. Baca Adem ka qenë krahu i luftës çlirimtare dhe vetë lufta, prandaj edhe thoshte, në çaste kur shpërtheja ndaj disa personave që, në emër të luftës bënin çdo të zezë: "Çupinë, këta të luftës i kemi më të afërt për kah gjaku...". Thoshte gjithashtu se: "Do të vijë një kohë dhe askush nuk do të mbetet pa u koritë sikur edhe se këta që kanë mbetur të gjallë do t'ua kenë lakmi atyre që kanë rënë për liri..." Shqiptar Demaçi duhet të përkrahët jo si politikan, por si ekspert për çështje mjedisore dhe shëndetësore. Nëse mbetet

në këto dy fusha, do ta ruajë edhe profesionalizmin, ndërsa nëse bën përpjekje të bëjë politika të larta, nuk e kam asnjë dyshim se "nga një profesionist shëndetësor i shkëlqyer, do të përfundojë në një politikan të dobët". Sikur të gjithë mjekët deri sot që janë munduar të bëhen politikanë të mëdhenj!

Shashivar Makolli - Qali: Shashivar Makolli - Qali ishte shok i ngushtë i Bacës Adem. Ishte shoqëruar i tij gjatë luftës kur të tjerët iknin nga Baca edhe kur e takonin në rrugë. Në kohën e paraluftës, gjatë luftës sidomos dhe atë të pasluftës Shashivar Makolli - Qali ishte shofer, truproji, këshilltar dhe shoqëruar i Bacës Adem dhe ishte në gjendje që në çdo kohë të sakrifikohej për Bacën. Jetën e Bacës Adem e çmonte 1 000 herë më shumë se të vetën. Nuk ishte e rastit që Shashivar Makolli - Qali i qëndroi Bacit afër në kohën kur fasulja hahej kokërr për kokërr, por se në çastet kur ishte lehtë dhe pa rrezik, ishte shoferi tjetër i tij, shoferi i paqes dhe i qejfit dhe zevkut. Shashivar Makolli - Qali ishte patriot që nuk diskutohej kurrë dhe asnjëherë. Nëse ëndërrohej për liri, çlirim dhe bashkim kombëtar, pjesë e pandashme e këtyre ëndrrave ishte Qali. Nëse vetëm njëri fliste për liri, çlirim dhe bashkim kombëtar, Shashivar Makolli - Qali i bëhej shok i pandarë dhe besnik. Nëse dikush fliste për luftë, Shashivar Makolli - Qali i printe, me armë në dorë, nuk fshihej prapa askujt. Nuk ka zhvillim apo takim ku është biseduar, ku janë bërë organizimet dhe veprimet për liri, çlirim dhe bashkim kombëtar e që nuk ka qenë i përfshirë edhe Shashivar Makolli - Qali. Nuk ka mundur të shkrepet qoftë edhe një plumb në Kosovë, Maqedoni apo Luginë të Preshevës e të mos ia ngrëhte këmbëzën Shashivar Makolli - Qali. Nuk ka aktivitet ilegal që është zhvilluar në Prishtinë dhe Kosovë e që nuk ka qenë aty edhe Qali. Të gjithë ata që janë marrë me aktivitete kombëtare e që kanë folur shqip janë strehuar në shtëpinë shqiptare të Shashivar Makollit - Qalit, kanë hëngër bukë shqip në këtë shtëpi e kanë gëzuar besnikërinë dhe mbrojtjen shqiptare nga Shashivar Makolli - Qali dhe, në

çdo çast dhe në çdo rrethanë, më parë do të kishte pësuar Qali se ilegalët e kombëtares shqiptare. Në shtëpinë shqiptare të Shashivar Makollit - Qalit janë organizuar qindra e mijëra takime ku është biseduar vetëm për çështje kombëtare, si të veprohet, si të luftohet dhe si të vdiset dhe të mos dorëzohemi në luftë për liri dhe bashkim kombëtar. Shashivar Makollit - Qalit nuk i ka mjaftuar që Shqipërisë t'i bashkohet vetëm Kosova, ka kërkuar bashkimin e të gjitha trojeve shqiptare, në të kundërtën keni rënë në belë me të. E ka gëzuar besimin 1 000 për qind të Bacës Adem Demaçit. Me mua e ka pasur të përbashkët se kemi simpatizuar për Barcelonën dhe Mesin, por se jemi ngatërruar për Enver Hoxhën shkaku se unë Enverin e kam dashur sikur Realin e Madridit (nuk e dua as 0 për qind), kurse Qali Enverin e ka dashur, jo më shumë se Barcelonën, por se krejt botën! Gjatë ligjërimeve dhe bisedave patriotike në shtëpinë shqiptare të Shashivar Makollit - Qalit, na ka shërbyer, më shumë për t'i dëgjuar bisedat që bëheshin, e bija Merita Makolli, sot kandi-

date për deputete të Kuvendit të Kosovës. Merita Makolli brumin e bisedave që e ka dëgjuar e ka përgatitur mirë, e ka ngjeshur mirë dhe tash, ndonëse jo fort e njohur në jetën politike, i plotëson të gjitha kushtet të bëhet një përfaqësuese dhe mbrojtëse e denjë e interesave kombëtare. Merita Makolli është vazhdimësi njerëzore, patriotike dhe politike e një patrioti të madh, sakrifikues dhe vetëmohues siç ishte Shashivar Makolli - Qali, nxënësi, studenti dhe mentori i Adem Demaçit - Bacit. Dardha bie nën dardhë sikur edhe në rastin e Shqipit. Shashivar Makolli - Qali personalisht dhe familjarisht e ka përkrahur luftën sikur që ka qenë pjesëmarrës në çdo protestë të organizuar nga LV dhe Albin Kurti, duke menduar se Albini vërtet e ka "baba" politik Bacën Adem Demaçin. Mendoj se Merita Makolli do të bëhet deputete e Kuvendit të Kosovës për ta vazhduar rrugën e Shashivar Makollit - Qalit dhe si ushtarë e bindur e Adem Demaçit - Bacit.

Bajrush Behrami - Bali: Bajrush Behrami - Bali ishte dhe shkoi

në përjetësi si bohem dhe artist. Vizionin njerëzor, politik dhe kombëtar e shprehte përmes artit dhe pikturave që i bënte. I burgosur disa herë dhe shumë i keqtrajtuar për aktivitet kombëtar dhe politik, asnjëherë nuk pati dilema për të ardhmen, bashkimin kombëtar si zgjidhje të vetme dhe të drejtë kombëtare. Nuk keni mundur të gjeni dhe takoni një të burgosur politik që e ruante aq shumë gjakftohtësinë, nuk e humbiste kurrë durimin dhe asnjëherë nuk e keni dëgjuar të jetë ankuar ndonëse nuk e kishte rrugën e shtruar me trëndafila. Ishte i palëkundur në përkrahje të Adem Demaçit - Bacës dhe në kohën kur Zyra e Përfaqësuesit Politik të UÇK-së në Prishtinë ishte një vend shumë i rrezikshëm, Bajrush Behrami - Bali, me Shashivar Makollin - Qalin ishin thuaja kujdestarë aty. Tolerancën e kishte virtyt, nuk kishte urrejtje ndaj askujt! Pas daljes sime nga burgu më 1990, në supermarketin "Vlora", biznes i familjes e që punonte 20 orë, Bajrush ishte vizitor i rregullt. Kishte shumë besim se liria nuk është larg, por se ishte shumë i bindur se nuk ka liri pa

sakrificë dhe pa gjak. Ishte mik dhe bashkëpunëtor i Bacës Ahmet Haxhiu, një patriot par excellence, i Qalit dhe i Ukshin Hotit. Rrallë shkruante, por më inkurajonte të shkruaj. Kishte një rreth jo fort të gjerë të shokëve dhe miqve në Besianë që iu besonte dhe me ta bisedonte lirshëm. Me Xheladin Rekalium i shkonte muhabeti fort sepse kishin koordinata të ngjashme kombëtare dhe politike. Asnjëherë nuk është larguar nga përkrahja ndaj Bacës Adem. Në atë kohë, të burgosurit politikë shqiptarë të Besianës, në mesin e të cilëve si figura që asnjëherë nuk u komprometua e as korruptua ishte Bajrush Behrami - Bali, më shumë ishim të rrezikuar nga Dega e LDK-së në Besianë se nga policia serbe. Menjëherë pasi dolëm nga burgu dhe filluam të konsolidoheshim, disa nga kryesia e LDK-së në Besianë që kishin urrejtje të papërkrahshme ndaj Bacës Adem dhe të burgosurve politikë, përkrahës të Bacës, mbanin mbledhje ku thoshin se "për ne LDK-në më të rrezikshëm janë të burgosurit politikë shqiptarë se Serbia...". Atëherë, të burgosurit politikë shqiptarë

kishin më shumë ndikim se të gjithë të tjerët dhe disa në LDK kishin frikë se do t'ua marrim pushtetin, ndonëse as që e kishim një qëllim të tillë! Bajrush Behramin - Balin e denoncuan shqiptarët, e torturuan shqiptarët që mendonin serbisht dhe flitnin shqip sikur që e dënuan shqiptarët e atij soji, por se Bajrush Behrami - Bali kurrë nuk e humbi besimin te shqiptarët, tërë jetën ua kushtoi përpjekjeve dhe luftës për liri për shqiptarët, fali edhe çka të tjerët nuk do të falnin sepse me shpirt dhe me mendje ishte artist, veprimin e kishte prej artisti, prandaj nuk kishte urrejtje në zemrën e tij. Bajrush Behrami - Bali nuk u vlerësua për së gjalli, mirëpo jeta dhe vepra e tij kombëtare, njerëzore dhe artistike e vendosi në panteonin e figurave më të shquara të kombit shqiptar dhe, në kohën kur shqiptarët do ta kenë mundësinë ta shkruajnë historinë e vërtetë, Bajrush Behrami - Bali do të shndritë si meteor në galaktikën shqiptare! Së bashku me Adem Demaçin - Bacin dhe Shashivar Makollin - Qalin dhe yjet e tjera të dëshmorëve të kombit!

Haradinaj shpalos zotimet për punësimin e personave me aftësi të kufizuara



EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka pritur të hënën në takim anëtarët e Shoqatës së Paraplegjikëve dhe të Paralizës së Fëmijëve të Kosovës, Handikos. Me këtë rast, Haradinaj ka thënë se ka një evidencë të punëve që janë kryer, por edhe të atyre që i

presin, siç është zbatimi i Ligjit për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, miratimi i koncept-dokumentit dhe hartimi i ligjit gjithëpërfshirës për personat me aftësi të kufizuara, mbështetja dhe rehabilitimi i këtyre personave, duke thënë se qeveria ka qenë e hapur ndaj të gjitha kërkesave, me theks të Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të

Kufizuara. "Kemi një listë të temave që duhet t'i kryejmë bashkë, udhëzime të tjera, akte nënligjore për pajisje ndihmëse dhe rehabilitim për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë, zbatim të ligjit për punësim, plan të veprimit, listë gjithëpërfshirëse, sigurim të mbështetjes për organizatat, si dhe funksionalizim të këshillit nacional për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara", ka

thënë ai. Më tej, kryeministri në detyrë Haradinaj tha se kushdo që vjen në krye të qeverisë së ardhshme nuk duhet të bëjë dallime në këto tema, por t'ia kushtojë vëmendjen e duhur kësaj kategorie, duke theksuar se është nder për të gjithë fakti që ka filluar zbatimimi për paraplegjikët, por edhe për personin që kujdeset për ta. Drejtori i Handikosit, Afrim

Maliqi, ka falënderuar kryeministrin në detyrë Haradinaj për pritjen, duke thënë se gjithmonë ka gjetur kohë t'i shtyjë proceset përpara. Më tej, Maliqi ka thënë se edhe ata kanë të drejtë të kenë qasje, punësim, edukim, të përfshihen dhe të jenë të barabartë me të gjithë qytetarët e vendit, dhe kjo mund të arrihet me një mobilizim jo vetëm të shoqërisë, por të gjitha institucioneve.

NGA TAKIMET ME ADEM GASHIN

Izet ABDYLI

Dje u takova me poetin Adem Gashi në restorantin "Edi 2". Takimet me të në mesditë pothuaj na janë bërë rituale. Bisedojmë kryesisht për artin poetik, por edhe për politikën. Takimi i djeshëm ishte disi më i veçantë. Ishte më ndryshe. Nuk isha mësuar ta shoh ndonjëherë në aso gjendje shpirtërore. Pranë kishte një faculetë letre të qullur nga lotët dhe ende po dëneste. Nuk e pyeta asgjë se e kuptoj që në situata të tilla njeriu ka nevojë për pak qetësi. Kisha parandjenjen se ai do të shpjegohej vetë. Dhe ashtu ndodhi. "A e lexove poezinë e Sabit Idrizit për gruan e tij. Më mbyti. Nuk po mund të përmbahem dot". Pas pak iu kujtua që llogarinë time në "Facebook" këtë muaj të Ramazanit do ta lë "zgjerueshëm". Do ta lexojë më tha: "Nuk mundem pa ta lexuar". Ende i mbërthyer nga emocionet filloi leximin e poezisë së Sabitit.

Sabit IDRIZI

BISEDA E FUNDIT ME TË (Gruas sime të ndjerë, Hajries)

Kështu

Posa t'ia japë syri i pranverës (më tha)
Do t'ia nisim shtëpisë

Po (ia ktheva) do ta ndërtoj më një shtëpi të re

Ndoshta deri atëherë (vazhdoi ajo me gjysmë zëri)
Do të punësohet njëri djalë

Po ia ktheva (i bindur se po e gënjeja) do të punësohet njëri

Posa të ndërtoj më shtëpinë (i shkëlqyen sytë nga gëzimi)
Do t'i marrim dy nuse të mira

Po ia (ktheva) do t'i martojmë të dytë përnjëherë:
Ramadanin e Liridonin
Do të na mbushet shtëpia me plot nipa e mbesa
(u fundos ajo krejtësisht në pellgun e ëndrrave të veta)
Ani kur të na vijë edhe ata të Linditës, të Albanës...

Po (ia ktheva) do të... (dhe dola jashtë e ia plasa vajit)

Kur u ktheva sërish në dhomë
Ajo tashmë ishte nisur pakthyeshëm
Dhe po fluturonte drejt yllit të vet

Në dy pika loti të kristaltë
Që ende po rrëshqisnin ngadalë faqeve të saj të vyshku-
ra
Po fundosej qetësisht një anije me ëndrra...

Gjatë leximit sërish e tradhtuan lotët, njëjtë ndodhi edhe me mua. S'kishte si të ndodhte ndryshe. Shpirti i poetit dhe ndjenja e dhemburia njerëzore për njeriun më të dashur ishin ngjizur në majat e artit poetik. Mbetëm disa çaste pa fjalë. Pastaj më tregoi se edhe ai kishte bërë një postim pak më herët se Sabiti, një poezi me motivin e kujtimeve për babanë e vet. I kërkova telefonin e tij që ta lexoj:

Adem GASHI

ARKIVI I FAMILJES SIME

Kur më vdiq babai më 1960
Unë s'isha veçse gjashtë vjeç
E një stinë

Krejt çfarë na la
Qe një dhimbje e madhe dhe një kutizë
Një arkëz e vogël që ruhej mbi një tra



Dikush ma pat falur një Abetare të vjetër
Me shumë mungesa fletësh
Veç zanoret qenë të gjitha dhe një h
E mjaftë për të formuar shtatë klithma
Shtatë pasthirmma, ah, rit i vjetër

Pastaj u rrita
Aq sa për ta hapur kutizën

Ç'të shihja
Një tapi e fshirë pronësie
Një foto të babait ushtar Serbie
(s'e di në qe Serbi e dytë a e parë)
Pastaj një letërnjoftim të Shqypnisë
Nën N.T.M Emanuelin
Me shqiponjën stemë vënë nën sëpatë

Kapitulli i socializmit
S'kishte veçse gjoba mali e fushe
Dëftesa të fryra tatimi
Me ftesa me tri vija të kuqe
Me vulë prej UDB-e

Lufta e fundit
e zhbëri edhe kutinë e vogël prej druri
tashti arkivi i familjes sime
s'është veçse një kujtim i portretit të babait
me shikim zhbirues ngjyrë tungji

Kjo poezi kishte marrë mbi 160 pëlqime dhe shumë komente, ndërsa më bëri përshtypje sugjerimi i poetit Gashi që ua bënë komentuesve: Të dashur, shumë të dashur, miq e mike të mia, për juve që lexuat, pëlqyet e komentuat këtu, kam një adresim të ri me lutjen: kërkoheni Sabit Idrizi dhe lexojeni kryeveprën e tij poetike, pa diskutim lirikën më të mirë të vitit "BISEDA E FUNDIT ME TË"! Ju jam mirënjohës pafundësisht!

Kur u qetësua pak ai po kërkonte ende diç në telefonin e

vet, mbase shikonte komentet në "Facebook" dhe mua vetiu më ngacmoi muza që ndjesinë e këtij çasti ta thur në vargje. Ai po vazhdonte kërkimin me kokën ulur dhe unë, po ashtu, po bëja sikur po kërkova diç në telefon e, në fakt, në notesin e telefonit po radhisja vargjet e një poezie që pas pak do t'ia jepja Ademit për lexim.

Izet ABDYLI

KUR QAN POETI PËR POETIN

Sot në 'Edi 2' e gjeta poetin e përlotur
ai dëneste e unë e vështroja me habi
asnjëherë nuk kisha parë lot në sytë e tij
mes çurkës së lotëve mezi foli:
më mbyti më bëri me vaj poeti Sabit Idrizi
me poezinë për gruan e tij
nuk mundem të mos ta lexojë edhe ty
vargjet më rëndonin si tungji
e jashtë binte shi
sërish u përlot ai
u përlota edhe unë
nuk kishte si të ndodhte ndryshe
kur dhembja e shtrirë në art
po ngjizej mes lotëve e mërzisë

"Edi 2", 30 maj 2019, 12.54

Ai sapo kish marrë pak veten duke e lexuar poezinë time sërish i rrëshqitën lotët. "Eu... - më tha - mu gjete edhe me këtë... po nashtë". E pashë në fytyrën e tij dhembjen njerëzore që asnjëherë nuk e kisha parë. Ma pohoi me kokë dhe me gjysmë zëri se poezia ime që rrodhi aty për aty i kishte pëlqyer. Kjo gjendje e rëndë mbase do të vazhdonte ende sikur të mos vinte pranë tavolinës sonë miku ynë Xhavit Gruda që do ta shtendoste këtë situatë duke i dhënë bisedës kah tjetër.

Jharrel Jerome fiton Emmy për herë të parë



Jharrel Jerome ka pranuar çmimin e tij të parë Emmy. 21-vjeçari mori çmim për "Aktori kryesor i shquar" për rolin e tij si Korey Wise në serinë "When They

See Us". "Ndihem sikur duhet të jem në Bronx tani duke pritur gatimin e nënës sime, por unë jam këtu", ka thënë Jharrel gjatë fjalimit të tij.

Miley dhe Kaitlynn, shoqe edhe pas ndarjes



Duket se Miley Cyrus dhe Kaitlynn Carter kanë marrëdhënie të mira pas lajmeve për ndarjen e tyre. Dyshja për të cilën raportohet së fundi se kanë ndërprerë lidhjen e tyre romantike janë ende duke mbështetur njëra-tjetrën siç dëshmohet nga një koment që

Kaitlynn i la Mileyt. Kaitlynn ka shkruar në "Instagram" për ta dhënë mendimin e saj mbi performancën e Miley në iHeartRadio Music Festival. "Get it" ishte komenti që ajo la nën fotografinë e këngëtares duke performuar në një veshje të zezë.



Mbretëresha e 'pëlqen' Meghan Marklen

Mbretëresha mund të ketë një të preferuar të ri. "Mbretëresha e pëlqen Meghanin", ka thënë historiani David Starkey për Richard Eden të "Daily Mail" në një festë. "Mbretëresha i bëri menjëherë ambasadorë atë dhe Harryn për punë të jashtme, që është e vetmja gjë për të cilën Mbretëresha interesohet me të vërtetë". Me gjithë vlerësimin e favorshëm, Starkey tha se e kaluara e Markles

si një aktore televizive amerikane është diçka kundër saj në sytë e familjes mbretërore. Problemi është se ajo ka sjellë edhe famën me vete prej Hollywoodit, por Meghani nuk është e vetmja anëtare e Mbretërisë që është në qendër të vëmendjes. "Diana, po ashtu, sillej si një person i famshëm", ka thënë Starkey, duke shtuar se ngjashmëria me vjehrrën e saj të ndjerë ka mundur ta tërheqë Princin Harry për ish-aktoren.

Ndërron jetë aktori Aron Eisenberg



Aron Eisenberg ka ndërruar jetë. Aktori vdiq në moshën 50-vjeçare. Lajmin e ka konfirmuar gruaja e tij Malissa Longo përmes një deklaratë në "Facebook". "Kurrë nuk do të ketë një dritë tjetër si Aron. Trashëgimia që ai la pas është përtej

fjalëve. E dua shumë dhe do të më mungojë përjetësisht. Për momentin, nuk di se si do ta bëj jetën pa të", ka shkruar ajo. Shkaku i vdekjes ende nuk dihet, megjithëse dihet që ai më parë kishte dy transplantime të veshkave.

E jashtëzakonshme

Mjekët përpiqen t'i heqin bririn që iu rrit mbi kokë

Kirurgët në Indi provuan t'i operojnë "bririn" që i ishte rritur një 74-vjeçari në kokë. Burri tha që briri kishte nisur t'i rritej që pesë vjet më parë. Fillimisht ishte mbajtur nën kontroll nga berberi, i cili e gërryente dhe e mbulonte me flokë. Por shumë shpejt nisi të bëhet i fortë, gjë që e detyroi ta kërkonte ndihmën e mjekëve.



FOTO E DITES



Një grua e moshuar mban një kapele në një miting për mjedisin në qytetin periferik Quezon në Filipine. /AP/

E rrallë

E fsheh drogën në një qofte

Kemi dëgjuar për shumë vende të çuditshme të fshehjes së drogës, por kjo është mënyra më e re që po hetohet nga policia. Në një video që tashme është virale në rrjetet

sociale shihet një grua që fsheh qese të bardha në një qofte. Kjo ka ngjallur dyshimet e policisë se kjo është metoda më e fundit e përdorur nga trafikantët.



BARSOLETA E DITËS



I sëmuri: Doktor, doktor kam edhe 50 sekonda jetë. Doktor: Prit edhe një minutë, të lutem!




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Çdo ditë në ora 15:30 **The Angry Birds Movie 2 (3D)**

Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 39 min
Rolet: Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj, etj.

Regjia: Thurop Van Orman



Në ora 17:30

GOOD BOYS

Aventurë/Komedi; 1 orë 29 min

Rolet: Jacob Tremblay, Keith L. Williams, Brady Noon, Molly Gordon, Lil Rel Howery, Will Forte, etj.

Regjia: Gene Stupnitsky




Çdo ditë në ora 19:15

"HOBBS & SHAW"

Aksion/Aventurë/Triller; 2 orë 15 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jason Statham, Idris Elba, Vanessa Kirby, Helen Mirren, etj.
Regjia: David Leitch




Çdo natë në ora 21:30 **ONCE UPON A TIME IN HOLLYWOOD**

Komedi/Dramë; 2 orë 41 min

Rolet: Leonardo DiCaprio, Brad Pitt, Margot Robbie, Al Pacino, etj.

Regjia: Quentin Tarantino



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: **Kino ABC**.




DASHI
Shqetësimet në lidhje me shtëpinë ose nënën

tuaj mund të nënkuptojnë se duhet të merreni me disa njerëz mjaft të pakëndshëm ose jo të besueshëm.



DEMI
Sot mund të merrni vesh disa thashetheme aspak të mira për veten.

për veten.



BINJAKËT
Mund të keni disa probleme tek ana financiare.

Dita do t'ju kalojë duke menduar se si t'i menaxhoni paratë.



GAFORRJA
Problemet në shtëpi ju japin idenë që të

shpërnguleni ose të bëni ndryshime.



LUANI
Intuita dhe imagjinata do të funksionojnë

në nivelin më të lartë sot, prandaj mund të keni një frymëzim për të shkruar.



VIRGJËRESHA
Mund të keni dyshime rreth një projekti që

ka domethënie të madhe për ty.



PESHORJA
Mendja juaj mund të jetë në luftë për

pushtet, gjë që mund të shkaktojë pak debat me miqtë tuaj.



AKREPI
Ëndrrat e ditës dhe fantazitë për vendet

e largëta ekzotike mund t'ju sjellin idenë që të lini gjithçka për të bërë disa pushime.



SHIGJETARI
Do të jeni shumë i mërziur dhe

humbur sot, por kjo gjë do të shkaktojë shqetësim te miqtë dhe familja.



BRICJAPI
Dita e sotme do të bazohet te

melankolia që nuk duket se ka ndonjë bazë në realitetin e duhur.



UJORI
Sot mund të ndiheni jo shumë mirë.

Ndoshta nuk jeni i sëmure, por mund të jeni lodhur.



PESHQIT
Ëndrrat e çuditshme, emocionuese

dhe të gjalla mund ta frymëzojnë krijimtarinë tuaj sot.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

14 gola në tri ndeshje të Superligës

Në vetëm tri ndeshje të zhvilluara në elitë janë shënuar plotë 14 gola, kurse fitores si vendas iu gëzua Ballkani, kurse si mysafir triumfuan Llapi dhe Drenica. Trajneri i Vushtrrisë, Antonio Toma është njoftuar me humbje nga skuadra e Ismet Munishit, Ballkani

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Java e gjashtë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll është mbyllur të hënën, kurse një ndodhi e veçantë ndodhi në këtë xhiro për faktin se në tri ndeshjet e zhvilluara janë shënuar plotë 14 gola. Skuadra e Llapi ka arritur fitore me rezultat bindës ndaj Flamurtarit (1-5), në ndeshjen që u zhvillua në stadiumin "Xhemal Ibishi" në Prishtinë. Kuqezinjtë u mbajtën vetëm dymbëdhjetë minuta, kurse Mentor Zhdrella e hapi serinë e golave. një minutë më vonë për 0-2 realizoi Mërgim Pevqeli, kurse në minutat shtesë të pjesës së parë realizoi edhe Memaj. Ky i fundit e shënoi e një gol në pjesën e dytë, derisa peshën e Llapit e kompletoi Angel Grancov, i cili realizoi autogol. Grancovi shënoi edhe golin e nderit për skuadrën e tij. Shtatë gola u shënuan edhe në ndeshjen e zhvilluar në Suharekë në mes



Ballkanit dhe Vushtrrisë, derisa vendasit triumfuan me rezultat 5-2. Në minutën e 19-të, Visar Berisha e hasi serinë e golave shënoi golin e parë në ndeshje, por mysafirët u kundërpërgjigjën në pjesën e parë duke barazuar nëpërmjet Drilon Fazliut. Tre minuta pasi

filloi pjesa e dytë Arbër Hoxha e rikthehu epërsinë e vendasve, derisa pas një ore lojë shënoi sërish kapiteni Visar Berisha për rezultat 4-1. Matheus De Paula pesë minuta para fundit e ngushtoi epërsinë e vendasve, por në minutat e fundit të ndeshjes Ermal Krasniqi e

vulosi rezultat final 5-2. Në këtë mënyrë trajneri italian Antonio Toma është njoftuar me humbje, në ndeshjen e tretë si trajner i Vushtrrisë. Ndryshe nga dy ndeshjet e para që u shënuan shumë gola, në ndeshjen e tretë në mes Ferizajt dhe Drenicës, një gol e përcak-

IPKO Superliga

Drita - Trepça '89	1-1
Dukagjini - Feronikeli	0-2
Ferizaj - Drenica	0-1
Ballkani - Vushtrria	5-2
Flamurtari - Llapi	1-5

Tabela

		PIKË
1. Feronikeli	6	12
2. Gjilan	6	12
3. Drita	6	11
4. Llapi	6	11
5. Ballkani	6	11
6. Drenica	6	8
7. Prishtina	5	7
8. Flamurtari	6	7
9. Trepça '89	6	6
10. Ferizaj	6	6
11. Vushtrria	6	5
12. Dukagjini	5	1

Në xhiron e radhës takohen: Feronikeli-Ferizaj, Llapi-Dukagjini, Trepça '89-Flamurtari, Gjilani-Drita, Vushtrria-Prishtina, Drenica-Ballkani.

toi fituesin e ndeshjes. Triumfuese doli skuadra nga Skenderaj, e cila të vetmin gol e realizoi në minutat shtesë të pjesës së parë me anë të Arbios Thaqi. Të mërkurën zhvillohet ndeshja e mbetur e xhiros se dytë në mes Prishtinës dhe Dukagjinit nga Klina. Kjo ndeshje pritet të luhet nga ora 18:00 në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë.

Nis 'Java Evropiane e Sportit' në Kosovë

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Në Prishtinë u hap "Java Evropiane e Sportit", një organizim i cili synon t'i aktivizojë qytetarët e Kosovës që të merren me sport dhe aktivitete fizike. Në ceremoninë e hapjes, ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Kosovës, Kujtim Gashi, para të pranishmëve priti një pjesë-marrje masive, rreth 22 mijë qytetarë, që organizohen anembanë Kosovës si një vazhdimësi e sukseseve nga viti i kaluar. "Vlerësimet për organizimin e vitit të parë kanë qenë shumë të mira. Më lejoni të ndaj me ju lajmin se Kosova për vitin e kaluar ka prirë me nivelin dhe seriozitetin e organizimit të javës dhe është ndër shtetet e rajonit që ka qenë me një nivel shumë të lartë. Si rezultat i kësaj, sivjet Bashkimi Evropian ka zgjedhur të financojë një ngjarje të posaçme e cila do të mbahet më 27 shtator në Suharekë. Me marrjen e detyrës si ministër jam angazhuar maksimalisht që ta plotësoj dhe avancoj infrastrukturën ligjore e fizike të sportit

ngaqë sporti është një fushë jashtëzakonisht e rëndësishme e cila sjell rezultate të shumanshme si dhe po promovon imazhin dhe shtetin e Kosovës në arenën ndërkombëtare", ka thënë Gashi.

Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, si nikoqir i ngjarjes "Forumi për sportin" në kuadër të Javës Evropiane të Sportit, tha se ky forum tash e tutje do të ketë punime të rregullta dhe qëllime shumë të qarta. "Forumi do të jetë tashmë i rregullt, në mënyrë që... një lloj 'brainstorming' të jetë, një hedhje e ideve dhe këtë e kam parë nga një përfaqësues i Federatës Botërore të Golfit në një panel ku ai ishte dhe ai tha se kemi nisur organizimin e forumeve në mënyrë që t'i dëgjojmë të gjithë hisedarët, të gjitha palët e interesit, për shqetësimet e tyre, në mënyrë që në fund të bëhen rekomandime dhe konkluzione që do t'i obligojnë organet vendimmarrëse t'i shqyrtojnë si një mundësi që edhe ato të fillojnë të implementohen", ka



deklaruar Hasani. "Java Evropiane e Sportit" sivjet shënon pesëvjetorin e theme-limit nga Komisioni Evropian,

ndërkaq nga e hëna e deri më 30 shtator në Republikën e Kosovës është planifikuar mbajtja e 84 aktiviteteve sportive të

cilat organizohen nën përkujdesjen e ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Kosovës, Kujtim Gashi.

Kosova e fitoi garën 'UEFA Development Tournament'

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës U15 në futboll e ka mbyllur në mënyrë triumfuese garën "UEFA Development Tournament" që u mbajt në Kamëz nën organiz-

imin e Federatës Shqiptare të Futbollit. Në ndeshjen e tretë dhe të fundit të këtij turneu "Dardanët" e rinj kanë shënuar fitore në duel me Shqipërinë me rezultat 1-0. Golin e fitores

për Kosovën e shënoi Elton Krasniqi. Kësisoj, Kosova e mbylli turneun me 9 pikë, me 12 gola të shënuar dhe asnjë të pësuar. Pozita e dytë i takoi Shqipërisë me 4 pikë, vendi i

tretë Estonisë me 3 pikë dhe Taxhakistani mbeti i fundit me 2 pikë. Në ndeshjen e parë Kosova e mundi Taxhakistanin 8-0, kurse në ndeshjen e dytë e mposhti Estoninë 3-0.



Katër klube pas dy trofeve të Superkupës

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Edicioni i ri në basketbollin e Kosovës fillon me dy ndeshjet e Superkupës, Prishtina - Bashkimi te femrat dhe Sigal Prishtina - Rahoveci te meshkujt. Ndeshjet zhvillohen në palestrën "Mizahir Isma" në Rahovec, që është organizatore së bashku me Federatën e Basketbollit të Kosovës.

Prishtina dhe Rahoveci ishin përballur edicionin e kaluar edhe në finale të "play-off"-it dhe Kupës, ku përballjet ishin shumë interesante. Tifozët pritet ta mbushin palestrën për të parë një spektakël të basketbollit, që është edhe nisja e edicionit të ri, ku pritet të jetë shumë interesant, sidomos me rikthimin e Pejës. Kapiteni i Sigal Prishtinës, Dardan Berisha, ka thënë se Superkupa është mënyra më e mirë për ta nisur edicionin e ri. "Deri më tani jemi përgatitur për ndeshjet e Ligës së Kampionëve, kurse tani jemi fokusuar për sfidën e Superkupës. Besoj se do të jetë një spektakël i basketbollit, pasi palestra do të jetë e mbushur me tifozë dhe më i miri të fitoj në fund. Sigurisht ne, pas titullit dhe Kupës, duam edhe trofeun e Superkupës, por me rëndësi është që të jetë një ndeshje e bukur për tifozët dhe të nisë edicionin e ri i basketbollit në mënyrë më të mirë të mundshme", deklaroi Berisha për faqen e FBK-së.



Ndërsa kapiteni i Rahovecit, Rron Grapci, pret një ndeshje të bukur për tifozët. "Ne jemi përgatitur për ta dhënë maksimumin në fushë. Shpresoj se do të jetë një spektakël për tifozët. Përparësia për ne është se do ta kemi ndihmën e tifozëve, derisa mendoj se Prishtina nuk është e fortë si e vitin e kaluar. Sidoqoftë, nuk do të jetë një ndeshje e lehtë për të dy palët dhe besoj se do të zhvillohet një ndeshje dramatike dhe skuadra që e meriton të fitojë në fund", ka thënë Grapci për faqen e FBK-së.

Kjo ndeshje fillon nga ora 20:30. Finalja e parë që do të zhvillohet do të jetë ajo në konkurrencën e femrave në mes të Prishtinës dhe Bashkimit, e cila fillon nga ora 17:30. Njëra nga basketbollistet më të dalluara të Prishtinës është Irma Konjusha. Ajo pret një lojë të mirë përballë vashave prizre-

nase. "Besoj se do të jetë një ndeshje shumë e mirë. Do të jetë një ndeshje e bukur edhe për tifozët, derisa lojtaret do ta japin maksimumin në fushë. Ne jemi duke u përgatitur dhe sigurisht që e duam trofeun e Superkupës", ka thënë Konjusha. Edhe basketbollistja e Bashkimit, Arbnore Përçuku, beson se do të jetë një ndeshje e bukur për tifozët. "Ndeshja e parë është gjithmonë e vështirë. Ne jemi përfunduar me disa lojtare dhe do të shihet se sa do të komponohemi gjatë ndeshjes, por edhe Prishtina është përfunduar. Ndeshja e parë e edicionit nuk është asnjëherë e lehtë. Besoj se do të zhvillohet një takim i bukur edhe për tifozët, duke parë cilësinë e dy skuadrave, derisa më e mira në fund do ta fitojë Superkupën", ka deklaruar Përçuku.

Përfaqësuesja po kompletohet, hendbollistet plot motiv

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Hendbollistet e Kosovës po punojnë me vullnet të madh për dy ndeshjet e para të fazës së dytë të kualifikimeve për "Euro 2020". Përfaqësuesja është e vendosur në Prishtinë dhe është kompletuar me ardhjen e Leonora Demajt, Mirela Gjokokajt dhe Fitore Aliut. Përzgjedhësi Agron Shabani është i kënaqur me angazhimin e lojtareve në stërvitje, kurse vlerëson se grupi do të jetë i kompletuar në tri stërvitjet e fundit. "Përgatitjet janë duke shkuar mirë. Po kompletohemi, ndërsa sot pritet të vijnë tri lojtaret e fundit. Në tri stërvitjet e fundit jemi komplet dhe të gatshëm për sfidat e reja. Vajzat kanë punuar me intensitet dhe janë të motivuara për këto dy ndeshje të radhës. Me kombëtaren nuk bashkohet këtë herë portierja Dorentina Osmani, kurse Ardiana Salihu



nuk ka mundësi t'i vazhdojë përgatitjet për shkak të një lëndimi. I dëshiroj shërim sa më të shpejtë", ka deklaruar përzgjedhësi Shabani. Ai nuk mund të llogaris edhe në

Suzana Ujkiq, që është në kompletim të dokumentacionit. Kosova të enjten takohet në Maribor me Slloveninë, kurse të dielën e presim Gjermaninë në Prishtinë.

SHKURT

Juve në garë për Muriqin

Vedat Muriqi është duke shkëlqyer në kampionatin turk me fanellën e Fenerbahçes, por edhe me fanellën e Përfaqësueses së Kosovës në futboll. Kjo ka bërë që disa skuadra të mëdha evropiane të futen në garë për transferimin e tij. Pas Manchester Unitedit, Atletico Madridit, Tottenham Hotspurit, Lazios, Napolit dhe Fiorentinës, në garë ka hyrë edhe skuadra e Juventusit. Lajmi është publikuar nga e përditshmja turke "Hurriyet".

Ramos: Reali është i uritur për fitore

Kapiteni i Real Madridit, Sergio Ramos, ka thënë se skuadra nga "Santiago Bernabeu" gjithmonë është e uritur për fitore. Reali e mposhti Sevillan me rezultat 0-1, kurse golashënues ishte Karim Benzema. "Ne e dinim se ndeshja do të ishte e vështirë, sepse ka vite që nuk fitojmë këtu. Erdhëm këtu me mentalitet të fortë dhe me qëllim për të bërë sa më pak gabime që është e mundur. Real Madridi është gjithmonë i uritur për të fituar. Ekipi është gjithmonë shumë optimist", ka thënë Ramosi.

Mourinho: Unitedi nuk është as për vendin e gjashtë

Jose Mourinho vazhdon të jetë pa një ekip, por mbetet protagonist në studiot televizive. Opinioni i tij në "Sky Sport" pas humbjes 2-0 të Manchesterit ndaj West Hamit ka ngjallur interesimin e tifozëve të "Djajve të Kuq". "The Special One" e pranoi se shkarkimi i tij nga detyra e trajnerit të Unitedit nuk ishte befasi. "U shkarkova dhe me siguri e meritoja të shkarkohesha nga puna sepse isha përgjegjës si trajner i skuadrës. Realiteti i trishtuar është se tani ata janë më keq se më parë. Kjo skuadër, për mua, është më e dobët se ajo e sezonit të kaluar", ka thënë Mourinho. Manchester Unitedi ka grumbulluar 10 pikë më pak se Liverpoolsi vetëm pas 6 javëve të para, një diferencë e ndjeshme që nuk e bën të lumtur trajnerin lusitan. "Për mua kjo është e trishtueshme. Ndoshta njerëzit mendojnë se unë jam duke e shijuar situatën, por nuk po e shijoj fare", ka shtuar ai. E ardhmja, sipas Mourinhos, nuk do të ofrojë optimizëm: "Ata me të vërtetë do të jenë në telashe jo vetëm sepse do të mbeten jashtë katër vendeve të para, por potencialisht nuk do të mund të renditen as në 6-shten më të mirë".

Neymar: Të shënosh është gjithmonë e mirë për vetëbesimin

Neymar vijon të jetë përcaktues për PSG-në, që falë golit të tij mori një tjetër fitore, këtë herë ndaj Lyonit. "Ishte një ndeshje shumë e vështirë. Lyoni ka ekip shumë të mirë, mbrojnë shumë mirë dhe janë shumë të rrezikshëm në kundërsulm. Nuk ishte ndeshje e përkryer nga ana jonë, por ne u treguam të ashpër dhe konsistentë. Të shënosh është gjithmonë e mirë për vetëbesimin. Shpresoj të vijoj në këtë mënyrë", ka thënë Neymar.

Icardi: U largova nga Interi sepse nuk fitova asnjë trofe

Mauro Icardi është larguar nga Interi gjatë verës. Sulmuesi argjentinas e ka thubtuar skuadrën italiane, duke thënë se është larguar për shkak se nuk ka fituar asnjë trofe. "Kam luajtur shtatë vjet tek Interi. Ëndrra ime ishte të luaja në Ligën e Kampionëve me ata dhe e realizova, por nuk fituam dot asnjë trofe. Ishte momenti që të luaja në një skuadër fituese dhe që koleksionon tituj. Të luaja në një skuadër me kampionë dhe që fiton trofe si PSG-ja ishte objektivi im. Wanda? Kush më njeh, e di çfarë personi jam. Me Wandën kam shtatë vjet. Mendoj se të dy bashkë morëm vendimin e duhur për të mirën e karrierës sime dhe të familjes", ka thënë Icardi.



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Trepça - Shoqëri Aksionare
Trepça - Deoničarsko Društvo
Trepça - Joint Stock Company



Adresa: Parku industrial Mitrovicë, Tel. 028/538 050, 531 135, Fax: 028/539 202 web: www.trepçacorporation.org
Address: Mitrovica Industrial Park. Tel. 028/538 050, 531 135, Fax: 028/539 202 web: www.trepçacorporation.com

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës, nenit 22 paragrafi 4 të Statutit të Trepçës, Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, dhe nevojave të paraqitura për plotësimin e disa vendeve të lira të punës, Trepça Sh.A me dt. 24.09.2019 shpall:

KONKURS

Për plotësimin e këtyre vendeve të lira

Punëtor në prodhim –

120 pozita në Stan Tërg dhe
30 pozita në Artanë;

a) Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Nxjerrjen e xehes dhe bartjen e xehes;
- Transportim me lokomotivë në minierë;
- Pastrim kanali në minierë;
- Riparim të oxhaqeve vertikale në minierë

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkuara:

- diplomën e shkollës fillore/mesme;

Inxhinier i Elektroenergjetikës (2 pozita në Stan Tërg):

a) Detyrat dhe përgjegjësitë:

- përkujdeset për stabilimentet elektro energjetike, stabilimente shpërndarëse, stabilimente elektroenergjetike të ventilimit, ajrimit të kompromituar, pompimit dhe stabilimenteve të ashensorëve;
- përkujdesje dhe mirëmbajtje të paisjeve të tensionit njëkahor si bateri industriale dhe lokomotivat;
- përpilimi i raporteve të rregullta për punën në fushat e përgjegjësive dhe detyrave të caktuara;
- koordinon punët me udhëheqësin e mirëmbajtjes dhe prodhimit rreth riparimeve të makinave dhe stabilimenteve
- planifikon furnizim me material elektrik

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkuara:

- Diplomë universitare në Inxhinieri të Elektroenergjetikës

Elektracist të Energjetikës (6 pozita në Stan Tërg):

a) Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen dhe mirëmban stabilimentet elektroenergjetike në minierë;
- Kryen dhe mirëmban paisjet e kombinuara energjetike, elektronike, pneumatike dhe hidraulike me tensione të kombinuara;
- Kryen dhe detyra shtesë të ndërlidhura dhe të caktuara nga udhëheqësi
- përpilimi i raporteve të rregullta për punën në fushat e përgjegjësive dhe detyrave të caktuara;

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkuara:

- Diplomë të shkollës së mesme;

Axhustatorë (6 pozita në Stan Tërg)

a) Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Monitorimi i sitemit të pompimit në minierë;
- Manipulimi i pompave (ndalje dhe lëshim) në punë;
- Rregullimi dhe ndërrimi i linjave të gypave me diametra të ndryshëm;
- Rregullimi i defekteve në pompa, valvula dhe gypa;
- Kryen ndërrimin e të gjitha paisjeve makinerike;
- Kryen ndërrimin e reduktorëve, motorëve pneumatik, sisteme komandimi me mekanik;
- Kryen ndërrimin e arkave të vagonetave, shasive, rrotave, cilindrave, gypave;
- Zëvendësimin dhe adaptimin e çdo lloj pjese.
- Prejten me autogjen i të gjitha konturave makinerike;
- Prejten e gypave të metaltë me diametra të ndryshëm në minierë
- Saldimin autogjen me tel të zi dhe me mesing

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkuara:

- Diplomë të shkollës së mesme;

Pompista (3 pozita në Stan Tërg)

a) Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Manipulim të pompave (ndalje dhe lëshim) në punë;
- Rregullim të valvulave dhe sasisë së ujit në minierë;
- Mbylljen e derës së ujit;
- Monitorimin e vazhdueshëm të nivelit të ujit brenda ndërrimit.

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkuara:

- Diplomë të shkollës së mesme;

Inxhinier i makinerisë (1 pozitë në Stan Tërg)

a) Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen riparimet mekanike të veglave, makinave dhe pajisjeve;
- Planifikon, organizon dhe përcakton prioritet për furnizim me pjesë rezervë;
- Planifikon dhe organizon kryerjen e testeve të pajisjeve sipas rregullave teknike;
- Organizon sistemimin dhe ruajtjen e literaturës profesionale dhe dokumentacionit teknik për vegla, makina dhe pajisje ekzistuese;

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkuara:

- Diplomë universitare në Inxhinieri Mekanike

Teknik i makinerisë (4 pozita në Stan Tërg)

a) Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen xhirimin e pjesëve, vizatimit dhe rikopjimit dhe përpunimin e dokumentacionit teknik për pajisje ekzistuese dhe konstruksioneve të reja;
- Shumëzon dhe siguron numrin e nevojshëm të kopjeve të vizatimeve dhe të njëjtat i ndan sipas llojit të makinave, në vende të caktuara për to;
- Përcjell shfrytëzimin kohor të makinave gjegjësisht shpenzimin e materialit dhe pjesëve rezervë, në bazë të raporteve ditore të shërbimit të depos dhe depos interne;
- Kryen edhe punë të tjera sipas urdhrat të udhëheqësit të përgatitjes teknike konstruksionit dhe kontrollit, të cilit drejtpërsëdrejti i është përgjegjës për punën e tij.

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkuara:

- Diplomë universitare në Inxhinieri Mekanike apo shkolla e mesme teknik i makinerisë

Teknik i energjetikës (4 pozita në Stan Tërg)

a) Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryerjen e të gjitha punëve elektrike dhe detyrave të marra nga personeli mbikëqyrës;
- Riparohet instalimin dhe ndriçimin e repartit;
- Ndihmojë në rregullimin e prishjeve elektrike në repart;
- Në brigadë të bëjë riparime në tërë repartin;
- Bën instalime të reja nën mbikëqyrjen e brigadierit.

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkuara:

- Diplomë universitare në Inxhinieri të Energjetikës apo shkolla e mesme për teknik të energjetikës;

Inxhinier i xehetarisë (1 pozitë në Stan Tërg)

a) Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgatit planet operative mujore;
- Bën zgjedhjen teknologjike me synim të arritjes së prodhimit dhe punon sipas marrëveshjes dhe udhëzimeve të udhëheqësit;
- Në bashkëpunim me shërbimet tjera bashkë planifikon riparimet vjetore dhe mujore të pajimeve të xehetarisë;

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkuara:

- Diplomë Universitare nga drejtimi i Xehetarisë

Saldues elektrik dhe me autogjen (2 pozita në Stan Tërg)

a) Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Saldimi i lidhësve dhe konstruksioneve;
- Saldimi i gypave dhe pajimeve të nxehtë;
- Saldimi i pjesëve të çelikut, saldimi i pjesëve të përgatitura, saldimi i konstruksionit, etj.
- Saldimi i gardheve, rrotave të vinçit, fondamenteve, i pjesëve të cilat përpunohen;
- Saldimi i pjesëve ku kërkohet që saldimi të jetë i pastër, dhe vendet e salduara nuk janë të ngarkuara me shtypje të lartë;
- Prejten me autogjen materiale me gjerësi deri 20mm;
- Saldimi i pjesëve thithëse të thjeshta;
- Saldimi i pjesëve të cilat nuk përpunohen;
- Vetëpërgatitja e aparaturës për saldimit;
- Kryen edhe punë të tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit;

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkuara:

- Diploma e shkollës së mesme

Metalgdhendës – turnitor (1 pozitë në Stan Tërg)

a) Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Punon në punën e përpunimit dhe punimit të pjesëve me pak të ndërlukuara dhe të thjeshta, sipas vizatimit të dhëne, skicës apo mostrës në toro apo makina tjera të destinuara për përpunimin e metalit;
- Bën përgatitjen e makinës për punë, vendos dhe i fikson elementet për punim, si dhe veglat për përpunim, programon makinën dhe kontrollon përpunimin e elementeve;
- Është përgjegjës për vëllimin dhe kualitetin e punëve të kryera, gjendjen e rregullt të makinave, veglave dhe mjeteve me të cilat manipulon, dhe pastërtinë e hapësirës punuese;
- Punon dhe punë tjera sipas urdhrat të mbikëqyrësit;

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkuara:

- Diploma e shkollës së mesme

Punëtor në Flotacion (Punëtorë në prodhim)

15 pozita në Tunel të Parë dhe

12 pozita në Kishnicë

a) Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përcjell hidrotanspordin e sterilizimit nga Flotacion gjerë ne deponi dhe anasjelltas;
- Përcjell për steril dhe për furnizimin e ujit industrial si dhe linjavc të koncentrateve për dekantuesit;
- Punon drejtpërsëdrejti në punët e thërrmimit, shoshitjes;
- Transporton dhe deponon xehen e thërrmuar në bunker;
- Bën kontrollimin e mullinjve;
- Rregullon procesin teknologjik të flotimit të metaleve të dobishme
- Punon në filtrimin e koncentrateve të mineraleve;
- Rregullon përcjelljen e pulpës dhe të dendësisë, shpejtësinë e filtrave.

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkuara:

- diplomën e shkollës fillore/mesme;

Inxhinier i makinerisë (1 pozitë në Artanë):

a) Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen riparimet mekanike të veglave, makinave dhe pajisjeve;
- Planifikon, organizon dhe përcakton prioritet për furnizim me pjesë rezervë;
- Planifikon dhe organizon kryerjen e testeve të pajisjeve sipas rregullave teknike;
- Organizon sistemimin dhe ruajtjen e literaturës profesionale dhe dokumentacionit teknik për vegla, makina dhe pajisje ekzistuese;

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkuara:

- Diplomë universitare në Inxhinieri Mekanike

Zyrtar Administrativ 2 pozita (1 Prishtinë, 1 Kishnicë)

a) Detyrat dhe përgjegjësitë

- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin harton planet e punës për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave;
- Ndihmon në vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime dhe përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës;
- Merr pjesë në hartimin, zhvillimin e procedurave dhe dokumenteve tjera si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre në fushën profesionale specifike brenda afateve kohore të caktuara;
- Organizon dhe lehtëson takime, konferenca dhe ngjarje të tjera të veçanta, koordinon dhe merr pjesë në mbledhjet e komisioneve sipas rastit;
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkuara:

- Diplomë universitare

Zyrtar Financiar (1 pozitë në Kishnicë)

a) Detyrat dhe përgjegjësitë

- Harton planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara;
- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin analizon dhe vlerëson realizimin e objektivave dhe planit të punës të njësisë dhe harton raporte mbi progresin e arritur dhe rekomandon përmirësime nëse kërkohet;
- Kryen edhe punë tjera profesionale në pajtim me qëllimin e vendit të punës.

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkuara:

- Diplomë universitare Fakulteti Ekonomik
- Së paku 1 vit përvojë punë perkatëse

Ndihmës kuzhinier (1 pozitë në Artanë)

a) Detyrat dhe përgjegjësitë

- Të asistojë në Punët e Kuzhinierit.
- Të pranon detyra nga Kuzhinieri, të bënë para përgatitjet e ushqimeve të ndryshme.
- Kryen detyra të tjera që mund të përcaktohen herë pas here nga Kuzhinieri.
- Të mbajë standardin e caktuar nga Kuzhinieri.

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkuara:

- Shkolla e mesme

Inxhinier i makinerisë (1 pozitë - Fabrika e pajimeve të procesit):

a) Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen riparimet mekanike të veglave, makinave dhe pajisjeve;
- Planifikon, organizon dhe përcakton prioritet për furnizim me pjesë rezervë;
- Planifikon dhe organizon kryerjen e testeve të pajisjeve sipas rregullave teknike;
- Organizon sistemimin dhe ruajtjen e literaturës profesionale dhe dokumentacionit teknik për vegla, makina dhe pajisje ekzistuese;

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkuara:

- Diplomë universitare në Inxhinieri Mekanike

Automekanik (1 pozitë - Fabrika e pajimeve të procesit)

a) Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Nën udhëheqjen e udhëheqësit përformon detyrat e dhëna në servisimin e automjeteve.
- Puna me diagnostikim, riparim / ndërrim te pjesëve, konstatimi i defekteve dhe eliminimi i tyre.
- Dhe punë të tjera të profilit të ngjashëm sipas nevojave të ndërmarrjes.

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkuara:

- Diplomë të shkollës fillore/mesme

Shef i kabinetit të Kryeshefit Ekzekutiv (1 pozitë)

a) Detyrat dhe përgjegjësitë:

- ka për detyrë të bëjë përgatitjen e materialeve dhe plotësimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin normal të veprimtarisë së përditshme të Kryeshefit Ekzekutiv, sipas axhendës së caktuar dhe miratuar paraprakisht prej tij;
- organizon punën për evidentimin, sistemimin dhe trejtimin e korrespondencës që i vjen Kryeshefit Ekzekutiv;
- kontrollon punën dhe koordinon veprimtarinë e të gjithë stafit të Kryeshefit Ekzekutiv.

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkuara:

- Të ketë diplomë universitare nga fakulteti juridik ose ekonomik;

Zëvendës drejtor i departamentit të sigurisë fizike (1 pozitë)

a) Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Është përgjegjës për ruajtjen dhe sigurinë fizike të pasurisë së Trepça Sh.A së bashkë me drejtorin;
- Bën kontrollimin e hyrjeve-daljeve të personave, mjeteve dhe automjeteve;
- Vëzhgimin e hapësirës së Trepçës;
- Informimin e organeve të rendit për çdo rast të dyshimtë apo të dëmtimit të pasurisë dhe personave;

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkuara:

- Diplomë Universitare;
- Së paku tri vite përvojë pune në menaxhim;

Sigurim fizik (3 pozita)

a) Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Mbikëqyrë hyrjen dhe daljen në objekt;
- E bën informimin e udhëheqësit për gjendjen e objekteve;
- E bën pranim-dorëzimin dhe e informon pjesëtarin tjetër të sigurimit mbi gjendjen dhe ndodhitë eventuale gjatë turnit të tij;
- Bën sigurimin e lokacionit përfshirë zyrat;
- Mbikëqyrë lëvizjen e personave dhe automjeteve;
- Parandalon incidentet dhe përkujdeset për tejkalimin e tyre;
- Bën kontrollin fizik të objektit dhe rrethit të ndërtesës;
- Kryen edhe punë të tjera të kësaj natyre sipas udhëzimeve të menaxherit të tij të cilat edhe i raporton për punën e vet.

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkuara:

- Diploma e shkollës fillore/mesme

Zyrtar i lartë i prokurimit (1 pozitë)

a) Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Menaxhon dhe organizon punën dhe aktivitet e prokurimit dhe siguron që të gjitha procedurat e prokurimit të zhvillohen në harmoni me ligjet dhe rregulloret e prokurimit;
- Planifikon, koordinon dhe përgatit aktivitet vjetore të prokurimit në ndërmarrje, bashkëpunon me personat përgjegjës të ndërmarrjes lidhur me hartimin e planit të prokurimit, kërkesave për prokurim, dhe analizon të arriturat, vështirësitë, kufizimet, etj nga aspekti i prokurimit;
- Bënë analiza, vlerësime dhe identifikon nevoja të reja me qëllim të realizimit të aktiviteteve të ndërmarrjes;
- Është përgjegjës për zbatimin e ligjit dhe akteve të tjera nënligjore të aplikueshme në Kosovë;
- Vendos në dosje dhe arkivon të gjithë dokumentacionin e zyrës së prokurimit;
- Harton raporte javore, mujore, tremujore dhe vjetore për të gjitha aktivitetet e prokurimit me të cilat është ngarkuar;
- Kryen dhe detyra të tjera të caktuara nga mbikëqyrësi;
- Mbron vlerën e organizatës duke ruajtur informacionin konfidencial.

b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkuara:

- Diploma universitare, fakulteti ekonomik apo juridik;
- 2 vite përvojë pune profesionale;
- Të jetë i certifikuar për prokurimin;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e prokurimeve dhe të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme në fushat e përgjegjësisë së ministrisë;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit, shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit).

Biolog (1 pozitë)

- a) Detyrat dhe përgjegjësitë:
- Të kryej kërkime, mbledh mostra dhe matje, kryen teste dhe eksperimente dhe interpreton dhe raporton për gjetjet e tyre në lidhje me jetën e bimëve në hapësirat e Trepçës;
 - Hulimtimi, identifikimi, klasifikimi dhe studimi i bimëve dhe ekosistemeve;
 - Mbatja e shënimeve të plota dhe të sakta në lidhje me hulimtimin ose vëzhgimin.
- b) Kushtet e veçanta dhe dokumentet e kërkuara:
- Diplomë universitare nga drejtimi Biologji

Zyrtar i Lartë Ligjor (1 pozitë)

- a) Detyrat dhe përgjegjësitë
- Me autorizimin e Sekretarit korporativ, përfaqëson dhe mbron interesat e Ndërmarrjes Trepça Sh. A. para organeve gjyqësore dhe institucioneve tjera përkatëse;
 - Hartimin i vendimeve, rekomandimeve, këshillave ligjore dhe akteve të tjera që i nxjerrë Menaxhmenti i Trepça Sh.A.
 - Përgatitjen dhe dhënien e këshillave juridike e procedurale, për parashtrës me karakter ligjor që i adresohen Ndërmarrjes Trepça Sh. A.;
 - Përgatit memorandume, marrëveshje dhe dokumente tjera ligjore me të cilat sigurohet administrimi efektiv dhe efikas i Trepça Sh. A.;
 - Bashkëpunon ngushtë me departamentet, zyrat dhe Njësit Biznesore të Trepça Sh. A., për çështje ligjore në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi;
 - Me autorizimin e Sekretarit Korporativ, merr pjesë në komisione dhe grupe përkatëse punuese brenda dhe jashtë Ndërmarrjes Trepça Sh. A.;
 - Përgatit raporte dhe mbanë evidenca lidhur me kryerjen e punëve brenda përgjegjësisë të Zyrës ligjore;
 - Kryen dhe detyra tjera shtese me urdhër të Sekretarit.
- b) Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:
- Njohuri të thellë dhe të specializuar në fushën e legjislacionit dhe hartimin e akteve ligjore;
 - Te kenë të përfunduar provimin e jurisprudencës, e obliguar;
 - Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
 - Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
 - Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
 - Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
 - Njohja e gjuhës angleze e preferueshme;
 - Diplomë universitare, minimum 1 vite përvojë pune profesionale.

Zyrtar Ligjor për çështje administrative (1 pozitë)

- a) Detyrat dhe përgjegjësitë:
- Siguron mbështetje të përgjithshme administrative, teknike dhe profesionale duke përfshirë dhe hartimin e dokumenteve të ndryshme;
 - Përgatit procesverbalet dhe shkresa tjera për Ndërmarrjen Trepça Sh. A.;
 - Ndihmon mbikëqyrësin në caktimin dhe koordinimin e takimeve të ndryshme dhe merr pjesë në takime nëse është e nevojshme;
 - Bënë hulumtime dhe analiza të informatave në tema të caktuara dhe identifikon opsionet ose çështjet për shqyrtim;
 - Përgatitë, modifikon dokumentet duke përfshirë korrespondencën, raportet dhe memorandumet për mbikëqyrësin;
 - Asiston në përmbushjen e detyrave të përgjithshme të zyrës ligjore;
 - Bashkëpunon dhe komunikon me njësitë tjera brenda dhe jashtë Ndërmarrjes për aktivitetet që ndërlidhen me fushën e legjislacionit;
 - Kryen dhe detyra tjera shtese me urdhër të Sekretarit korporativ;
- b) Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:
- Njohuri në fushën e legjislacionit dhe fushës Administrative;
 - Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
 - Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
 - Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
 - Njohja e gjuhëve të huaja e preferueshme;
 - Diplomë universitare, minimum 1 vit përvojë pune profesionale

Zyrtar Ligjor (3 pozita)

- a) Detyrat dhe përgjegjësitë:
- Ndihmon në hartimin e akteve normative si dhe akteve tjera juridike të cilat dalin nga fushë veprimtarie e Ndërmarrjes e me theks te veçantë në **Njësit Biznesore në kuadër të Trepça Sh.A.** në bazë të procedurave të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi;
 - Bën hulumtime dhe analiza të informatave në temat e caktuara dhe identifikon opsionet ose çështjet për shqyrtim.
 - Sipas kërkesës dhe sipas udhëzimeve te sekretarit jep opinione ligjore si dhe bën hartimin e projekt-marrëveshjeve, projekt-vendimeve dhe projekt akteve të tjera;
 - Bashkëpunon dhe komunikon me njësitë tjera brenda dhe jashtë Ndërmarrjes për aktivitetet që ndërlidhen me fushën e legjislacionit;
 - Kryen edhe punë tjera në pajtim me qëllimin e vendit të punës të cilat mund të kërkohen kohë pas kohe nga sekretari.
- b) Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:
- Njohuri në fushën e legjislacionit dhe hartimin e akteve ligjore;
 - Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
 - Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
 - Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;

- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
- Diplomë universitare, minimum 1 vit përvojë pune profesionale.

Auditor i Brendshëm (2 pozita)

- a) Detyrat dhe Përgjegjësitë:
- Raportojë tek udhëheqësi për çështjet e rëndësishme dhe të rekomandojë përmirësime të mundshme;
 - Siguron që aktivitetet e shoqërisë Trepça Sh.A. të jenë në harmoni me të gjitha rregullat ligjore dhe statutin e saj;
 - Në bashkëpunim me mbikëqyrësin merr pjesë në hartimin e planit të Auditimit, planit strategjik dhe programin e Auditimit të brendshëm të pranueshëm nga udhëheqësi i njësisë së Auditimit të brendshëm;
 - Kryen dhe udhëheq auditime përfshirë intervistat hyrëse në sektorin që auditohet interviston stafin, merr dhe analizon, dokumentacionin përkatës dhe regjistron të gjeturat;
 - Përgatit raportin, diskuton me mbikëqyrësin dhe bën intervistën përfundimtare me të audituarin;
 - Harton raportin final, me rekomandimet adekuate, finalizon dosjen e Auditimit dhe dorëzon për arkivim;
 - Përcjell zbatimin e rekomandimeve nga ana e Menaxhmentit dhe udhëheqësit e njësive organizative të Trepça Sh.A.;
 - Me udhëzimin nga udhëheqësi i NjAB mbikëqyrë dhe kryen kontrolla të brendshme me qëllim të vlerësimit të shkallës së eliminimit të parregullsisë të konstatuara më parë;
 - Ofron këshilla për çështje të Auditimit brendshëm brenda Ndërmarrjes Trepça Sh.A., sipas nevojës;
 - Koordinon punën me pjesë tjera të Ndërmarrjes Trepça Sh.A., dhe komunikon me autoritetet e jashtme sipas nevojës;
 - Të vlerësoj sistemet kontrollit e brendshëm të dizajnuara nga menaxhmenti i lartë se a janë adekuate.

b) Kualifikimi, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Diplomë universitare në ekonomi, administratë publike, financa publike, kontabilitet, juridik, (me përparësi njohësit e fushave të gjecologjisë, metalurgjisë dhe xehtarisë)
- Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit);
- Njohuri dhe përvojë substanciale në fushën e Auditimeve;
- Njohuri e ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathtësi të komunikimit, planifikimit të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në programet kompjuterike Windows, Word, Excel dhe Acces.
- Të ketë kryer me sukses trajnim rigoroz profesional dhe testimin për auditor të brendshëm;
- Të jetë i certifikuar si auditor i brendshëm;
- Të zhvilloj vazhdimisht njohurit, aftësitë profesionale për të ruajtur licencën për auditor të brendshëm duke marr pjesë në trajnime në minimum 30 orë brenda vitit etj.

Përkthyes nga gjuha shqipe në atë angleze dhe anasjelltas (1 pozitë)**a) Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- përkthimi me shkrim nga gjuha shqipe në atë angleze dhe anasjelltas të të gjitha materialeve të Trepça Sh.a dhe njësive të saj;
- përkthimi simultan dhe konsektiv nga gjuha shqipe në atë angleze dhe anasjelltas;
- përkthimi e shkresave, vendimeve, kërkesave, memorandumëve, kontratave në Trepça Sh.a.
- përkthimi simultan dhe konsektiv (shqip-anglisht-shqip) në konferenca, takime dhe grupe pune të tjera si dhe ndihmon në formulimin gjuhësor të fjalimeve në të dy gjuhët (shqip dhe anglisht),
- kryerjen edhe të punëve të tjera të caktuara nga udhëheqësi.

b) Kualifikimi dhe përvoja:

- diplomë fakulteti në lëmin e gjuhës angleze,
- përvojë profesionale, së paku 2 vjet në përkthim të legjislacionit në institucione.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Trepça Sh.A., ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Dokumentet përcjellëse si vijon:

- Dëshmitë për kualifikimet arsimore dhe profesionale (diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i),
- Letërnjoftimin kopje,
- Certifikatën nga gjykata që nuk është i dënuar.
- Dëshminë e përvojës së punës.

Dokumentacioni duhet të dorëzohet në Divizionin e burimeve njerëzore, Ndërtesa e Menaxhmentit të Trepça Sh.A, Parkun Industrial në Mitrovicë çdo ditë pune nga ora 8 deri në ora 16.

Dokumentacioni i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen për intervistim.

Afati i konkurrimit është 15 ditë nga dita e shpalljes në gazetë.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurrimit nuk do të pranohen.

Për informata shtesë, ju lutemi telefononi në numrat: 028/538-050.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
 Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
 Ministry of Education, Science and Technology

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) shpall

Konkurs për tekstet shkollore dhe materialet mësimore

për klasat 3, 8 dhe 12 për vitin shkollor 2020/2021, sipas Ligjit 02/L-67 për botimin e teksteve shkollore dhe materialeve mësimore.

I. DOKUMENTET KRYESORE

Tekstet shkollore dhe materialet mësimore duhet të jenë në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi dhe dokumentet e mëposhtme:

1. Ligjin për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/8-lbtmldp-2008-03-1048.pdf>
2. Kornizën Kurrikulare të Kosovës, <http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-kurrikulare-finale.pdf>
3. Kurikulat Bërthamë:
 - 3.1. Për klasën përgatitore dhe arsimin fillor, <http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/kurrikula-bërthamë-1-finale-2.pdf>;
 - 3.2. Për arsimin e mesëm të ulët: <http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-bërthamë-2-final.pdf>;
 - 3.3. Për arsimin e mesëm lartë: <http://masht.rks-gov.net/uploads/2018/04/korniza-kurrikulare-23102016-finale.doc>
4. Plan-programet lëndore, Web-masht: <http://masht.rks-gov.net/arsimi-parauniversitar>
5. Standardet për tekste shkollore; <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/standardet-e-teksteve.pdf>

II. KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR DORËSHKRIMIN

1. Dorëshkrimet që nuk janë në përputhje me dokumentet e lartpërmendura nuk do të merren në shqyrtim.
2. Për secilën lëndë mësimore duhet të dorëzohen libri bazë (obligativ) për nxënësit, materialet mësimore plotësuese (jo-obligative) dhe libri i mësimdhënësit (obligativ).
3. Të gjitha materialet e përgatitura dorëzohen në version të shtypur, me ngjyrë dhe në version elektronik në Word dhe PDF të ruajtur në USB apo CD.
4. Dorëshkrimet dorëzohen në 6 kopje.
5. Libri për mësimdhënësin përmban:
 - 5.1. Udhëzime për zbatimin e metodologjive të ndryshme pedagogjike dhe shembuj për zhvillimin e njësive mësimore;
 - 5.2. Udhëzime për punë me nxënësit me nivele dhe stile të ndryshme të nxënies duke synuar arritjen e rezultateve të nxënies dhe zhvillimin e kompetencave të përcaktuara me kurrikulën e re;
 - 5.3. Sugjerime për materialet që mund të përdoren për zhvillimin e njësive mësimore dhe përdorim të burimeve tjera të informacionit.
6. Dorëshkrimet përmbajnë referenca për të dhënat dhe burimet e informacionit që përmban teksti.
7. Ilustrimet, fotografitë, tabelat, grafikonet dhe lehtësuesit e tjerë pamor të njësive mësimore duhet të jenë kualitative, të kenë rezolucion të mirë, relevante për njësinë mësimore dhe moshën e nxënësve. Të gjitha duhet të jenë origjinale dhe jo paragjyquese.
8. Autori/ja dhe/apo shtëpia botuese, mund të konkurrojnë vetëm me një dorëshkrim për tekst shkollor dhe material mësimor për klasën dhe lëndën e njëjtë.

III. KËRKESA TË VEÇANTA PËR TEKSTE SHKOLLORE DHE MATERIALE MËSIMORE PËR KLASAT 3, 8 DHE 12:

1. Teksti shkollor është në përputhje me planin dhe programin mësimor.
2. Teksti shkollor është në funksion të zotërimit të njohurive, shkathtësive dhe rezultateve të nxënies të parapara për lëndën dhe klasën konkrete.
3. Teksti shkollor është i përshtatur me qëllimet edukative - arsimore dhe kompetencat e parapara me Kornizën kurrikulare për arsimin parauniversitar.
4. Teksti shkollor ofron përmbajtje në përputhje me të arriturat bashkëkohore të fushës së caktuar shkencore, metodologjinë e mësimin të lëndëve dhe përdorimin e terminologjisë profesionale.

5. Teksti shkollor respekton gjuhën standarde dhe rregullat e drejtshkrimit. Përjashtime mund të ketë vetëm kur përdoren fragmente nga literatura artistike dhe nga tekstet e dialektologjisë.
6. Teksti shkollor nxit të menduarit kritik dhe kreativ të nxënësve.
7. Aparatura didaktike e tekstit shkollor është në përputhje me kërkesat bashkëkohore për të nxënësit aktiv dhe kreativ.
8. Teksti shkollor përmban fjalor për interpretim të fjalëve dhe koncepteve të panjohura ose më pak të njohura.
9. Teksti shkollor u përshtatet moshës dhe karakteristikave zhvillimore të nxënësve.
10. Teksti shkollor ka funksion edukativ, e nxitë raportin pozitiv ndaj shkencës/ diturisë, zhvillimit të identitetit nacional dhe qytetar, kulturor dhe të barazisë gjinore.
11. Teksti shkollor respekton barazinë gjinore, eliminon stereotipet dhe përdorimin e gjuhës diskriminuese.
12. Nëse dorëshkrimi nuk është në përputhje me dokumentet dhe me kërkesat e veçanta të përcaktuara me pikat I, II, III dhe IV të këtij konkursi, nuk do të shqyrtohet.

IV. KONKURSI ËSHTË I HAPUR PËR KËTO TEKSTE SHKOLLORE DHE MATERIALE MËSIMORE

Tekstet për klasën e tretë

Fusha kurrikulare	Lënda	Teksti shkollor/materiali mësimor
Gjuhë dhe komunikim	Gjuhë shqipe Turkçe Bosanski	Gjuhë shqipe Turkçe Bosanski jezik
Artet	Edukatë figurative Edukatë muzikore	Edukatë figurative Edukatë muzikore Resim Egitimi Muzik Egitimi Likovno Vaspitanje Muzicko Vaspitanje
Matematikë	Matematikë	Matematikë
Shkencat natyrore	Njeriu dhe natyra	Njeriu dhe natyra
Shoqëria dhe mjedisi	Shoqëria dhe mjedisi	Shoqëria dhe mjedisi
Jeta dhe puna	Shkathtësitë për jetë	Shkathtësitë për jetë
Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti

Tekstet për klasën e tetë

Fusha kurrikulare	Lënda	Teksti shkollor/materiali mësimor
Gjuhë dhe komunikim	Gjuhë shqipe Turkçe Bosanski Jezik	Gjuhë shqipe Turkçe Bosanski jezik
Artet	Art muzikor Art figurativ	Art muzikor Art figurative Resim Egitimi Muzik Egitimi Likovno Vaspitanje Muzicko Vaspitanje
Matematikë	Matematikë	Matematikë
Shkencat natyrore	Fizikë Kimi Biologji	Fizikë Kimi Biologji
Shoqëria dhe mjedisi	Histori Gjeografi Edukatë qytetare	Histori Gjeografi Edukatë qytetare Tarih Istorija
Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
Jeta dhe puna	Teknologji me TIK	Teknologji me TIK

**Tekstet për klasën e dymbëdhjetë
Gjimnazi shoqëroro - gjuhësor**

Fusha kurrikulare	Lënda	Teksti shkollor/materiali mësimor
Gjuhë dhe komunikim	Gjuhë shqipe dhe letërsi Bosanski Jezik i Knjozevnost Turk Dili ve Edebiyati	Gjuhë shqipe dhe letërsi Bosanski Jezik i Knjozevnost Turk Dili ve Edebiyati
Artet	Art figurativ	Art figurativ
		Resim Sanati
		Likovno Umjetnost
Matematikë	Matematikë	Matematikë
Shoqëria dhe mjedisi	Edukatë qytetare Histori Psikologji Filozofi dhe logjikë Sociologji	Edukatë qytetare Histori Psikologji Filozofi dhe logjikë Sociologji
		Tarih
		Istorija
Jeta dhe puna	Teknologji e Informimit dhe Komunikimit-TIK	Teknologji e Informimit dhe Komunikimit-TIK
Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti

**Tekstet për klasën e dymbëdhjetë
Gjimnazi i shkencave natyrore**

Fusha kurrikulare	Lënda	Teksti shkollor/materiali mësimor
Gjuhë dhe komunikim	Gjuhë shqipe dhe letërsi Bosanski Jezik i Knjozevnost Turk Dili ve Edebiyati	Gjuhë shqipe dhe letërsi Bosanski Jezik i Knjozevnost Turk Dili ve Edebiyati
Matematikë	Matematikë	Matematikë
Shkencat natyrore	Biologji Fizikë Kimi Astronomi Gjeografi	Biologji Fizikë Kimi Astronomi Gjeografi
		Teknologji e Informimit dhe Komunikimit-TIK
		Teknologji e Informimit dhe Komunikimit-TIK
Jeta dhe puna	Teknologji e Informimit dhe Komunikimit-TIK	Teknologji e Informimit dhe Komunikimit-TIK
Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti

INFORMATA TË TJERA

- Konkursi është i hapur që nga data/ dita kur publikohet në gazetën ditore.
- Afati për dorëzim të dorëshkrimeve fillon me datën e publikimit në gazetën ditore dhe përfundon me 2020, kur edhe duhet të dorëzohen të gjitha dorëshkrimet në MASHT.
- Vendi i dorëzimit: MASHT - Departamenti për Arsimin Parauniversitar DPTSH-zyra për tekstet shkollore
- Dorëshkrimet dorëzohen në gjashtë (6) kopje të shtypura dhe elektronike dhe duhet të përmbajë: librin bazë, librin e mësimdhënës si dhe materialet tjera mësimore (fletore pune apo të ngjashme).
- Dorëshkrimet duhet të jenë të mbyllura në zarf.
- Subjekti pjesëmarrës në konkurs bashkë me dorëshkrimin i dorëzon këto dokumente:
 - Deklarata nën betim - e nënshkruar dhe e vulosur
 - Vërtetimi nga Administrata Tatimore
 - Vërtetimi nga Gjykata themelore
 - Certifikata e regjistrimit të biznesit
 - Regjistrimi i numrit fiskal
 - Regjistrimi i TVSH-së.

**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
K. e Prizrenit • O. Prizren • Prizren B.
Sh.FMU-ONSŠ-IAOOO
"Bajram Curri"
Romajë**

Kërkesa për shprehje të interesit
Emri i shkollës: "Bajram Curri" vendi Romajë
Komuna: Prizren
Data: 24.09.2019

Nr. 249/19 Dt. 23.09.2019

Numri i kontratës: ESIP/SDG/82 - CS/1.4	Emri i kontratës: Trajnimi Menaxhim, Administrim dhe udhëheqje në Arsim, te
--	--

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shfmu "Bajram Curri" Romajë, Prizren. Objektivi i nën-komponentit 1.2. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës.

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme: Trajnimi: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e dy kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme;
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe personelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;


Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e ngjashme (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK). Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: Shfmu "Bajram Curri" Romajë, Prizren, më së largu deri më datën: 02.10.2019 Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë:

Detajet kontaktuese të shkollës:
Personi kontaktues: Refki Demaj
Telefoni: 044/113196
E-maili: refki-demaj@hotmail.com



Kërkesa për shprehje të interesit
Emri i shkollës: "Dy Deshmoret"
Komuna: Lipjan
Data: 24.09.2019

Numri i kontratës: ESIP/SDG/041-CS/1.4	Emri i kontratës: Strategjitë e nxënies eksperimentale
---	---

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës "Dy Deshmoret" Dobraje e Madhe Lipjan. Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme: Trajnimi: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit.
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe personelin e shkollës.
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.


Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë. Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë; Kriteret e vlerësimit:



- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e njëjtë (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK). Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: SHFMU "Dy Deshmoret" Dobraje e Madhe, Lipjan deri më 02.10.2019. Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:
Personi kontaktues: Nuhi Berbatovci
Telefoni: 044-470-260
E-maili: nuhi16@hotmail.com



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
 KOMUNA E PRIZRENIT - OPŠTINA PRIZREN
 Prizren Belediyesi
 Kryetari i Komunës - Predsednik Opštine
 Beledije Başkanı

Nr. 01/2019-2 18.09.2019
Komuna e Prizrenit
Opština Prizren - Prizren Belediyesi

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Kryetari i Komunës
Nr. 01-2019-2
Datë: 18.09.2019
Prizren

Në bazë të nenit 11 paragraf. 1, 2 dhe 4 lidhur me nenin 4 paragraf.1 dhe paragraf.2, nën paragraf. 2.2., 2.3., 2.4. nën paragraf. 2.4.3.1. të Ligjit nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/ L-205 të datës 28 tetor 2010 të Republikës së Kosovës dhe nenit 44 dhe 45 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligji Nr. 05/L - 031, merr:



VENDIM PËRFUNDIMTAR

- Aprovohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken me realizimin e projektit për Ndërtimin e rrugës në Lagjen "Gurishta", sipas tabelës që i është bashkangjitur këtij vendimi.
- Në bazë të vlerësimit të bërë nga ana e Ministrisë së Financave-Zyra për vlerësimin e pronave të paluajtshme, CAKTOHET lartësia e kompensimit për të gjitha pronat e shpronësuara.
- Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Organi Shpronësues i dërgon Vendimin subjektivit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara.
- Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Organi Shpronësues bënë shpalljen e Vendimit në gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
- Kundër këtij vendimi kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve në Gjykatën kompetente në Prizren, vetëm për shumën e kompensimit të përcaktuar në këtë vendim. Subjekti kërkues, personat të cilët janë pronar ose zotërues të interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim si dhe çdo person i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura të këtij vendimi.
- Brenda 5 (pesë) ditëve kalendrike par dorëzimit të ankesës në Gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që 5 (pesë) kopje të ankesës të i dorëzohen fizikisht në Zyrën Ligjore të Organit përkatës shpronësues, nëse parashtruesi i ankesës nuk vepron në përputhje me këtë paragraf Gjykata e refuzon ankesën.
- Brenda 2 (dy) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit, Organi shpronësues do të paguaj plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
- Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Vendimi u dërgohet:

Pronarit ose zotëruesit të interesit
Subjektit kërkues
Arkivi

Organi Shpronësues
Kryetari i Komunës
Prof. Dr. Mytaher Haskuka

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
 KOMUNA E PRIZRENIT - OPŠTINA PRIZREN
 Prizren Belediyesi
 Kryetari i Komunës - Predsednik Opštine
 Beledije Başkanı

Nr. 01/2019-2 18.09.2019
Komuna e Prizrenit
Opština Prizren - Prizren Belediyesi

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Belediye Başkanı
No. 01-2019-2
Tarih: 18.09.2019
Prizren

Kosova Cumhuriyetin 03/L-205 sayılı 28 Ekim 2010 tarihli Yasa ile yapılan değişiklik ve tamamlamalar ile taşınımların malın kamulaştırılması ile ilişkin 03/L-139 sayılı Yasanın 11.maddesi 1., 2. ve 4. fıkrası 4.maddesi 1. ve 2. fıkrası ve 2.2., 2.3., 2.4. alt fıkrası 2.4.3.1. alt fıkrası ve 05/L-031 sayılı İdari Süreç Yasasının 44.maddesi ve 45.maddesi gereğince işbu:



NİHAİ KARARI
alır

- İşbu Karara eklenen tabloya göre, "Gurishta" semtinde yolun İnşaa edilmesi gibi gerçekleştirilecek projeden etkilenen mal ve çıkar sahiplerin gayrimenkul mülkiyetlerinin kamu çıkarı ile ilgili kamulaştırılması Onaylanmıştır.
- Maliye Bakanlığı-taşınımla malların değerlerindirilme Dairesi tarafından yapılan değerlendirmeye göre tüm kamulaştırılan mülkiyetlerle ilgili tazminat miktarı BELİRLENİYOR.
- İşbu Kararın alınmasından 5 (beş) iş günü içerisinde, Kamulaştırma Makamı talep oluşumuna ve belirtilen tablolarda tespit edilen kişilere Kararı iletir.
- İşbu Karar onaylandıktan 10 (on) iş günü içerisinde, Kamulaştırma Makamı Kosova Cumhuriyeti Resmi gazetesinde ve Kosova'da büyük tirajlı bir gazetede Kararı ilan eder.
- İşbu Karara karşı oluşumların 30 (otuz) günlük zaman süresi içerisinde Prizren'de yetkili Mahkemesine, sadece işbu Karar ile belirtilen tazminat miktarıyla ilgili, talepçi oluşum mülkiyet hakkı olan, ayrıca doğrudan ve nihai Kararın objesi olan taşınımların maddi yasal çıkarı olan her kişi, işbu Karara eklenen tablolarda tespit edilip edilmediğine bakmaksızın şikayet etme hakkı vardır.
- Yetkili Mahkemeye şikayet teslim edildiği günden 5 (beş) takvimsel gün içerisinde şikayet sunan yetkili Kamulaştırma Makamı yasal dairesine 5 (beş) adet şikayet kopyasını teslim etmelidir, eğer şikayet sunan işbu fıkrada yazanlara uymazsa şikayet Mahkeme tarafından reddedilir.
- Kararın yürürlüğe girdiği tarihten itibaren 2 (iki) yıl içerisinde Kamulaştırma Makamı, işbu Karar ile belirtilen kamulaştırma tazminat tutarının tamamını ödeyecektir.
- Karar, Kosova Cumhuriyeti Resmi gazetesinde ve Kosova'da büyük tirajlı bir gazetede ilan edildiği günden yürürlüğe girer.

Karar aşağıda yer alanlara iletilecektir:

Mal sahibi veya çıkar sahibi
Talepçi oluşum
Arşiv

Kamulaştırma Makamı :
Belediye Başkanı
Prof. Dr. Mytaher Haskuka

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
 KOMUNA E PRIZRENIT - OPŠTINA PRIZREN
 Prizren Belediyesi
 Kryetari i Komunës - Predsednik Opštine
 Beledije Başkanı

Nr. 01/2019-2 18.09.2019
Komuna e Prizrenit
Opština Prizren - Prizren Belediyesi

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Predsednik Opštine
Br. 01-2019-2
Dana: 18.09.2019
Prizren

Na osnovu člana 11 paragraf. 1, 2 i 4 u vezi sa članom 4 paragraf.1 i paragraf.2, podparagraf. 2.2., 2.3., 2.4. podparagraf. 2.4.3.1. Zakona br. 03/L-139 za Eksproprijaciju Nepokretnih Imovina sa izmenama i dopunama uradenim Zakonom Br. 03/ L-205 od dana 28 oktobra 2010 Republike Kosova i člana 44 i 45 Zakona za Procedure Opšte Administracije, Zakona Br. 05/L - 031, donosi:


ZAVRŠNA ODLUKA

- Usvaja se eksproprijacija za javni interes nepokretnih imovina vlasnika i nosioca interesa, koji se dotiču realizacijom projekta za Izgradnju puta u naselju „Gurishta“, po tabeli koja je dostavljena ovom odlukom.
- Na osnovu procene uradene od strane Ministarstva za Finansije-Kancelarija za procenjivanje nepokretnih imovine, ODREĐUJE SE visina nadoknade za sve eksproprijacione imovine.
- U toku 5 (pet) radnih dana nakon donošenja ove Odluke, Eksproprijacioni organ šalje Odluku traženom subjektu i ostalim osobama identifikovanim na određenim tabelama.
- U toku 10 (deset) radnih dana nakon usvajanja ove Odluke, Eksproprijacioni Organ vrši objavljivanje Odluke u Službenim Novinama Republike Kosova i u jednoj novini sa najvećim tiražom na Kosovu.
- Protiv ove Odluke subjekti imaju pravo da podnesu žalbu u roku od 30 (trideset) dana nadležnom Sudu u Prizrenu, samo o iznosu nadoknade određenom ovom Odlukom, traženi subjekat-bilo koja osoba koja je vlasnik ili nosioc interesa na nepokretnu imovinu ili vlasnička prava dotaknuta ovom Odlukom, kao i svaka osoba koja ima jedan direktan legitiman interes i materijal na nepokretnoj imovini a koji je objekat Završne Odluke, nezavisno ako je identifikovan ili ne na dostavljenim tabelama ove Odluke.
- U toku 5 (pet) kalendarskih dana nakon dostavljanja žalbe nadležnom Sudu podnosioc žalbe treba da osigura da se 5 (pet) kopije žalbe dostave fizički pravnoj kancelariji odgovarajućeg eksproprijacionog Organa, ako podnosioc žalbe ne deluje u skladu sa ovim paragrafom, žalba se odbija.
- U toku 2 (dve) godine od dana stupanja na snagu Odluke eksproprijacioni Organ će plaćati celokupan iznos nadoknade eksproprijacije, određen ovom Odlukom.
- Odluka stupa na snagu na dan objavljivanja u Službenim Novinama Republike Kosova i u jednim novinama sa najvećim tiražom na Kosovu.

Odluka se šalje:

Vlasnik ili nosioc interesa
Podnosioc zahteva
Arhiva

Eksproprijacioni organ:
Predsednik Opštine
Prof. Dr. Mytaher Haskuka



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLICA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS/ VLADA KOSOVO / GOVERNMENT OF KOSOVO
 Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
 Departamenti i Tahimit në Pronë

Komuna: Prizren Zona Kadastrale:Prizren

Nr.	Pronar	Numri i pronës	Kultura / Klasa	Të dhënat sipas Elaboratit / Fletës Poseduese			Vlerësimi sipas ZVPP-së			Totali (€)
				Sipërfaqja e Përgjithshme m ²	Sipërfaqja për shpronësim m ²	Sipërfaqja e mbetur m ²	Çmimi i tokës (€ /m ²)	Vlera për dru pyjor dhe frutor (€)	Vlera e Investimit (€)	
1	NPN Bushi	5197-0	Arë e klasës 4	2689	430.71	2258.29				
2	Emin (Destan) Krasniqi	5195-0	Arë e klasës 4	6997	128.55	6868.45				
3	Sebehate Baruti 1/20; Zeqrije Sellimko 1/20; Rasim sellimko 1/20; Senar (lind.Baruti) Jëlliqi 2/50; Besim (Meqije) Baruti 6/50; Sebajdin (Fahri) Baruti 2/50; Remzi (Nezir) Rexha 1/20; Sevime (lind.Rexha) Zhitija 1/20; Resmije (lind.Rexha) Kodra 1/20; Nazmije (Beqir) Sellimko 1/20; Nermin (Ruzhdi) Kurkuli 1/20; Shpresa (Dervish) Dobroshi 1/5; Myterem (Mehmet) Sejdulla 1/10; Muharem Lalosh 1/10	5194-1	Arë e klasës 4	452	144.50	307.5				
4	Rasim Amrullahi	5194-16	Arë e klasës 4	352	89.30	262.7				



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGJENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Numër: 482/1
Datë: 23.09.2019

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAPARr), në bazë të nenit 13 dhe 34 të Ligjit të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/26 Mars), në bazë të Ligjit Nr. 04/1-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ nr. 14/2014, Udhëzimit Administrativ nr. 02/2014, si dhe në bazë të kërkesës së Qendrës së Kompetencës në Prizren shpall:

Ftesë për ofertë

Për Furnizim me uniforma për nxënës, mësimdhënës dhe stafin teknik të Qendrës së Kompetencës në Prizren.

Ftojme ofertuesit e kualifikuar që të paraqesin ofertat e tyre në zarfë të mbyllur.

Operatorët ekonomik me rastin e aplikimit duhet të sjellin:

1. Certifikata e regjistrimit të biznesit nga ATK.
2. Certifikata e numrit fiskal nga MTI-ATK.
3. Certifikata e deklaramit të TVSH-së nga ATK.
4. Vërtetimin tatimor se i ka kryer pjesërisht apo plotësisht detyrimet
5. Kërkojmë uniforma me material cilësor dhe paraprakisht të gjithë aplikuesit duhet të dorëzojnë mostrën e uniformave për djem, vajza ,mësimdhënës dhe staf teknik.
6. Referencat e operatorëve ekonomik .
7. Furnizimi i uniformave të bëhet për 40 ditë nga dita e publikimit të ofertës gjër më ditën e dorëzimit të uniformës, në të kundërtën do të zbatohet masa ndëshkuese për mos përmbushje të kontratës 10% (kjo nënkupton faktin se çmimit të kontraktuar të furnizimit i zbritet 10 % për secilën uniformë shkollorë dhe kjo vlerë i kthehet nxënësit).
8. Për mësimdhënësit kërkohet sigurimi i uniformave cilësore (mantil deri në gjunjë), ndërsa për punëtorët teknik përveç furnizimit me mantil duhet të paisen edhe me jelek .
9. Logo e QK-së duhet të jetë sipas modelit që jemi përcaktuar që në fillim të aplikimit të uniformave në QK (modifikime të tjera nuk pranohen).
10. Të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të jenë origjinale ose fotokopje dhe të vërtetuara!
11. Ofertuesit duhet ta deponojnë nr e llogarisë rrjedhëse të biznesit të tij që ti bëhet pagesa nëpërmes bankës.
12. Pagesa e Uniformave bëhet pas përmbushjes së 100 % të marrëveshjes

Kushtet tjera:

- Afati i fundit i dorëzimit të uniformave data Dorëzimi i uniformave nga data
- Cilësia e uniformave duhet të jetë e njejtë me mostrën e dorëzuar në momentin e aplikimit

Mënyra e aplikimit:

- Ofertat dorëzohen në Agjencinë e AAPARr-së

Vlerësimi i ofertave:

Hapja e ofertave bëhet me komision në ambientet e Agjencion per Arsim dhe Aftersim Profesional dhe Arsim te te Rriturve, Prishtine.

Kriter për përzgjedhjen e operatorit ekonomik do të jetë oferta¹ më e përshtatshme ekonomike.

Secili ofertues duhet të aplikojë vetëm me një ofertë

Pa dorëzimin mostrës (një model për vajza dhe një model për meshkuj dhe nje mantil për mësimdhënës) ofertat nuk pranohen.

Ofertuesit e interesuar ofertat e kompletuara me dokumentacionin e kërkuar t'i dorëzojnë në Agjencinë e AAPARr-së, Prishtinë rruga "Agim Ramadani" ndërtesa MASHt-të II kati i tretë, gjatë orarit 08:00-15:00.

Afati i paraqitjes se ofertave është shtatë (7) ditë nga dita e shpalljes në gazetën ditore, hapja dhe vlerësimi i ofertave bëhet në ditën e mbylljes së konkursit në ambientet e Agjencinë e AAPARr-së.

Aliismet ÇOÇAJ, drejtor

¹ "Çmimi i ofertës më të lirë" (nuk do të jetë si kriter për përlitimin e ofertës,por kriteri kryesor do të jetë cilësia e uniformës së ofruar).



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGJENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 489/1

Datë: 23.09.2019

Anulim i Ftesës për ofertë

Anulohet ftesa për ofertë e publikuar në të përditshmen "Epoka e Re", me dt. 14.09.2019 më nr. 463/1 për:

Për ekskursion të maturantëve të Qendrës së Kompetencës në Ferizaj, në Republikën e Shqipërisë.

Nga pjesëmarrësit në ofertë kërkojmë mirëkuptim.



Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lumë's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Në 21 vjetorin e rënies heroike të bashkëshortit dhe babait tonë të shtrenjtë

MUSTAFË (Shaqir) SHYTI

(10.10.1945- 24.09.1998)



Vitet po ikin e ne po jetojmë me dhimbjen, mallin, kujtimin por edhe madhësinë Tënde.

*Me mall dhe dashuri të përjetshme!
Bashkëshortja; Elhemja,
fëmijët: Vjollca, Berati,
Merita, Jehona,
Kushtrimi e Saranda
dhe mbarë familja Shyti.*



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)

- ★ ABC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Fundao Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola CeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zolal CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Parlex Sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Eduard Bytyqi shpall të pavlefshëm dëftesat klasës: 10, 11, 12 dhe diplomën e "Loyola Gymnasium- Prizren.
- ▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merrret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veterikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.